

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Drejtësisë
Studime pasdiplomike



Tema e magjistraturës

“Vrasjet serike aspekte krahasuese dhe nacionale”

Kandidat:

Agon Shaqiri

Mentor:

Prof.D-r. Ismail Zejneli

Tetovë , 2018

Deklaratë ndershmërie

Unë Agon Shaqiri nën përgjegjësinë e plotë morale dhe penale, deklaroj se kjo tezë është vepra ime origjinale, gjatë punimit të temës së magjistraturës kam respektuar rregullat ligjore mbi pronësinë intelektuale dhe çdo citim apo pjesë të punimi tjetër janë të shoqëruara me fusnota sipas standarteve metodologjike.

PËRMBAJTJE

Abstrakt

1.Qëllimi i studimit.....	8
2.Metodologjia.....	9
3.Arsyeshmëria e punimit.....	10
HYRJE	11

PJESA E PARË

1.Aspektet juridiko-penale të veprës penale Vrasje	13
1.1.Vrasjet e kualifikuara.....	14
1.2.Vrasjet e privileguara.....	16
1.3.Aspekt krahasues i vrasjes si vepër penale.....	18

PJESA E DYTË

2. Fenomenologjia e vrasjeve serike.....	22
2.1. Etiologjia e vrasjeve serike.....	23
2.2. Faktorët që ndikojnë në krytjen e vrasjeve serike.....	24
2.3. Pasqyrë krahasuese e vrasësve serik të gjinisë femërore dhe mashkullore.....	27
2.4. Tipologjia e vrasësve serik.....	26
2.5. Tipologjia e vrasësve serik sipas Holmsit dhe De Berger (Holmes and De Berger).....	30

PJESA E TRETË

3.Të dhëna statistikore.....	34
3. 1. Të dhëna statistikore ndërkombëtare për vrasjet serike.....	34
3.2. Të dhëna statistikore nga vendet ne rajon.....	37
3.3. Të dhëna statistikore ne nivel global.....	38

3.4. Të dhëna statistikore për vrasjet në Republikën e Maqedonisë.....	45
--	----

PJESA E KATËRT

4. Studime rasti –case study në nivel botërorë.....	55
4.1. Rasti.1.....	55
4.2. Rasti.2.....	57
4.3. Rasti.3.....	58
5. Studim rasti- case study në kornizat e Republikës së Maqedonisë.....	60
5.1.Rasti.1.....	60
5.2. Rasti.2.....	63
Konkludime dhe Rekomandime.....	66
Bibliografia.....	69
Shtojcë	73

Abstrakt

Vrasjet serike janë fenomen që për sistemin juridik të një vendi, i cili përballet me të njejtën, paraqesin sfidë, por në të njejtën kohë kjo është një shfaqje apo formë devijante që paraqet një kërcënim të madh për mirëqenien dhe sigurinë e popullatës së një vendi. Vendi ku më së shumti kryhen vrasje serike janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse ky fakt nuk i përjashton edhe vendet e tjera.

Në pyetjen se çka i shtyn më së shumti një person të paraqitet apo të shëndrrohet në një vrasës serik dhe pyetja se pse këto vepra të tmerrshme dhe të panatyrshme egjostjnë, për të njejtën nuk mund të jepet përgjigje e vetme dhe e sakt. Egzistojnë faktorë të shumtë të cilët marrin rol dhe kanë rrënjët në shumë sfera si p.sh. problemet financiare, gjendja psikologjike e një personi, familje jofunkcionale, anomalitë kongjenitale si dhe motive të ndryshme të tilla si, për shembull, dëshira për hakmarrje, pakënaqësi seksuale, hedonizëm etj.

Bota deri më sot është përbalhur me një numër të madh të vrasësve serik të rrezikshëm të cilët kanë marrë jetën e mijra njerëzve të pafajshëm duke përfshirë këtu edhe fëmijë, disa prej tyre kanë dalë përpara drejtësisë dhe e kanë vuajtur dënimin e merituar për veprimet e tyre por fatëkeqësisht numri më i madh mbetet ende i pazbuluar dhe mister në vendin ku kanë ndodhur ngjarja kjo për arsye të arratisjes së kryesit, provave të pamjaftueshme, joefikasiteti i organeve të ndjekjes penale etj.

Pikërisht, lëndë e kësaj teme masteri do të jenë Vrasjet serike aspekte krahasuese dhe nacionale, duke munduar të shpjegojmë vrasjet serike si fenomen, pse ato ndodhin për të analizuar në mënyrë statistikore paraqitjen e tyre në nivel ndërkombëtarë e global e për tu ndalur dhe në vendet e rajonit dhe paraqitjen e tyre në Republikën e Maqedonisë. Në fund për së afërmi do njoftohemi me ngjarje të vërteta që kanë ndodhur në botë dhe në Republikën e Maqedonisë, që do paraqesin studime rasti apo case study të këtij punimi.

Fjalë kyçe: vrasës serik, spekt krahasues, nacionale, motiv, faktorë, prova, vend ngjarje, Republika e Maqedonisë, studim rasti, fenomenologji, etiologji.

Апстракт

Сериските убиства се феномен кои за еден правен систем на една земја, која се соочува со истите, претставува голем предизвик, но во исто време тоа е појава на девијантна форма што претставува голема закана за благосостојбата и безбедноста на населението на една земја. Земјата во која се извршени повеќе сериски убиства е САД, иако овој факт не ги исклучува и другите земји.

На прашањето што е она што го тера едно лице да се појави или да се претвори во еден сериски убиец, и прашањето зошто постојат овие ужасни и неприродни дела, за истите не може да има единствен и точен одговор. Постојат многу фактори кои ја превземат улогата и имаат корени во многу сфери, на пример. финансиски проблеми, психолошката состојба на некое лице, дисфункционални семејства, вродени аномалии и разни мотиви како што се, на пример, желбата за одмазда, сексуалното незадоволство, хедонизам итн.

Светот до денес се соочувал со голем број на опасни сериски убијци кои ги зеле животите на илјадници невини луѓе, меѓу кои и деца, некои од нив се изведени пред правда и биле казнати како што заслужувале за своите постапки но за жак поголемиот дел останувале неоткриени и мистерија на местото каде што се случил настанот и тоа поради бегството на сторителите, недостаток на докази, неефикасноста на органите на прогонот и др.

Токму предметот на оваа мастер теза ќе биде сериски убиства споредливи и национални аспекти, обидувајќи се да ги објасниме сериските убиства како феномен, зошто се појавуваат ,статистички да го анализираме нивниот настап во меѓународно и глобално ниво и да запреемее во земјите од регионот и нивниот изглед во Република Македонија. На крајот, ќе бидеме од блиску запознаени со реалните настани што се случија во светот и во Република Македонија, во кои ќе бидат презентирани студии на случај или case study на овој труд.

Клучни зборови: сериски убиец, компаративен спектар, национален, мотив, фактори, докази, локација на настанот, Република Македонија, студија на случај, феноменологија, етиологија.

Abstract

Serial killings are a phenomenon that poses a challenge to the legal system of a country that faces the same, but at the same time it is a deviant or deviant form that poses a great threat to the well-being and security of a country's population. The country where most serial killings are committed is the United States, although this fact does not exclude other countries as well.

In asking what drives a person to appear or turn into a serial killer, and the question of why these terrible and unnatural acts exist, there can not be a single and correct answer. There are many factors that take on the role and have roots in many spheres, for example. financial problems, a person's psychological condition, dysfunctional family, congenital anomalies, and various motives such as, for example, desire for revenge, sexual dissatisfaction, hedonism, etc.

The world to date has faced a large number of dangerous serial killers who have taken the lives of thousands of innocent people, including children, some of them have come to justice and have been serving the deserved punishment for their actions but the biggest number is still undiscovered and mystery at the place where the event happened because of the perpetrator's escape, insufficient evidence, the ineffectiveness of the prosecution bodies etc.

Precisely, subject matter of this master theme will be the comparative and national serial killings, trying to explain the serial killings as a phenomenon, why they occur to statistically analyze their appearance at international and global levels and to stop in the countries of the region and their appearance in the Republic of Macedonia. In the end, we will be closely acquainted with real events that have taken place in the world and in the Republic of Macedonia, which will present case studies or case studies of this paper.

Key words: serial killer, comparative spectrum, national, motif, factors, evidence, event location, Republic of Macedonia, case study, phenomenology, etiology.

1. Qëllimi i studimit

Njeriu është një qenie e ndërlikuar. Që nga fillimi i ekzistencës së tij, ai është përpjekur të përshtatet me mjedisin, por në të njëjtën kohë të përshtasë mjedisin me kushtet e veta. Zhvillimi i civilizimit ka qenë gjithmonë dhe do të jetë në varësi të drejtpërdrejtë nga fantazia, vullneti, puna dhe vizioni njerëzor, por të gjitha fenomenet tjera që vijnë së bashku me evolucionin njerëzor janë gjithashtu rezultat i paaftësisë njerëzore, antagonizmit, frikës, dominimit...Krimi si një fenomen negativ shoqëror dhe vrasjet si një nga format më të rënda të rrezikimit të interesave jetike dhe thelbësore paraqesin anën negative të specieve tona.

Që të kuptohet shfaqja e vrasjeve serike, është e nevojshme të ndërtohet një figurë e plotë për të njëjtën, si dhe të tregohet situata jo vetëm në botë, por edhe në territorin tonë, për të depërtuar në thelbin e problemit. Përveç kësaj, rezultatet e këtij hulumtimi mund të përdoren në analiza dhe studime të mëtejshme në lidhje me subjektin tonë të interesit, i cili do të kontribuonte në rezultate edhe më të mëdha dhe më të suksesshme.

Në këtë kontekst, përpunimi i kësaj teme dhe produkti i saj final mund të përdoren veçanërisht në ato vende ku ky lloj i krimit është më i zakonshëm për shkak të njohjes së saj, duke studiuar dhe informuar publikun e gjerë. Për më tepër, elaborimi i temës dhe nxitja për të drejtuar vëmendjen në te mund të jetë shoqërisht e dobishme në mënyrë që të ndikojë në parandalimin e këtij fenomeni që është një segment kyç. Përmes analizës së saj duhet të respektohen ndryshimet shoqërore që mund të mbajnë shenja paralajmëruese të nevojshme për një reagim në kohë.

2. Metodologjia

Për shkak se bëhet fjalë për një çështje vërtetë serioze që rrezikon më të shenjtën e njeriut - jetën e tij dhe integritetin fizik dhe psikologjik si dhe dinjitetin e tij, për të nxjerrë në pah rëndësinë e të njejtës do të përdoret analiza e të dhënave statistikore përmes të cilave do të merret një pasqyrë rreth drejtimit të lëvizjes së këtij fenomeni si në territorin tonë ashtu edhe në mbarë botën.

Për kuptim më thelbësor dhe të thellë të problemit, do të përdoret metoda e studimit të rastit-case study. Gjithashtu, në mënyrë që të marrim informacionin e duhur do të përdoret metoda historike-krahasuese përmes të cilës do të zbulohet mënyra në drejtim të objektit të interesit dhe zhvillimin e saj, si dhe konturat e saj paraqitëse aty ku është më e pranishme, sikur që janë ato vende më të ballafaquara me këtë problem, kanë përvojën më të madhe në zgjidhjen e tij dhe në ofrimin e informacionit të besueshëm.

Të dhënat do të nxirren nga burimet dytësore përmes metodave të listuara më parë, me qëllim që të përmbushet qëllimi i hulumtimit si dhe kontrollimi i hipotezave, edhe atë:

- Të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë;
- Statistikat ndërkombëtare që përmbajnë të dhëna për karakteristikat përkatëse të vrasjeve serike, numrin e tyre, vendndodhjen, kohën, etj;
- Kodet penale të vendeve të tjera në pjesën që është objekt i interesit tonë;
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë;
- Analiza e rasteve gjyqësore.

Rezultatet e arritura do të shfaqen përmes tabelave, grafikonëve dhe përqindjeve.

3.Arsyeshmëria e punimit

Është evidente që bota e sotme po bëhet gjithnjë e më e rrezikshme për të jetuar. Njeriun e zakonshëm e përndjekin lloje të ndryshme të rreziqeve, duke përfshirë edhe një nga më të tmerrshmit, kërcënimi për vetë jetën. Disa studiues thonë se edhe vrasjet përfaqësojnë përgjigje normale dhe të pritëshme në një mjedis të mbipopulluar, lufta për mbijetesë dhe mundësitë jo të barabarta për sukses. Megjithatë, e drejta për jetë, është e pacenueshme dhe duhet të mbetet. Mbrojtja e saj është pikërisht justifikimi shkencor për këtë hulumtim përmes rezultateve të së cilës do të kuptojmë se çfarë është përgjigjja më të mirë dhe se si të luftojmë vrasjet serike, çfarë masash duhet të ndërmerren dhe a janë të njejtat adekuate, çfarë duhet të jetë reagimi shtetëror, nëse janë të nevojshme ndryshime legjislative, çfarë stafi duhet të përfshihet në këtë fushë, nëse nevojiten ndryshime institucionale etj.

Mund të konkludohet që janë të nevojshme aktivitete reformuese të caktuara si për shembull komuniteti më intenzivisht dhe në mënyrë të qartë të proklamojë dhe zbatojë strategji për refuzimin e dhunës të çdo lloji, dhe gjithashtu nëpërmjet kontrollës formale të autoriteteve shtetërore, duhet të ndikohet në kontrollin shoqëror joformal të ashtu quajtur angazhim dhe involvim më të madh me qëllim tu ndihmohet të rrezikuarve dhe të dëmtuarëve.

Sidomos duhet tu kushtohet vëmendje shenjave të para të dhunës që shpesh manifestohen tek fëmijët dhe adoleshentët. Kjo mund të arrihet duke krijuar një shumëllojshmëri të programeve të përshtatura për nevojat dhe rastet individuale të fëmijës në të cilën pjesëmarrësit do të jenë prindërit dhe të afërmit, dhe gjithashtu duhet të punojnë për përfshirjen më të madhe të profesionistëve, si psikologë, psikiatër, mësuesit dhe edukatorët parashkollor dhe moshës shkollore. Në të njëjtën kohë, me ndihmën shtetërore dhe mbështetjen financiare mund të formojnë institucione të caktuara që do të merren me këtë çështje. Sa i përket stadiumit final të tashmë ndërtuarit vrasësit serik dhe sjelljes së të njejtit para drejtësisë në këtë rast duhet folur dhe debatuar publikisht dhe me zë të lartë, duke mos lejuar që ky lloj krimi të vendoset në sfond. Përkundrazi, shteti duhet ta dënojë ashpër një akt të tillë.

Hyrje

Ndonëse gjatë trajtimit dhe hulumtimit të kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale, shpeshherë, në shikim të pare fitohet përshtypja se në paraqitjen e tij, rëndësi kryesore ka personaliteti i kryerësit dhe se veprimet e tij devijante janë rezultat i strukturës dhe vetive të tij të brendshme, kjo përshtypje, në realitet, nuk është e drejtë, pasi që personaliteti formohet dhe është i kushtëzuar nga një varg faktorësh të natyrës objektive, e në rend të pare të faktorëve ekonomikë dhe shoqërorë. Në këtë drejtim, theksohet se zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në procesete formimit të njeriut dhe personalitetit të tij. Të gjitha këto kanë ndikim të caktuar në veprimet dhe sjelljet kriminale.

Personaliteti i njeriut është i ndërtuar në baza psikike dhe biologjike. Këto janë dy komponente me rëndësi për zhvillimin dhe formimin e tij si personalitet normal. Njeriu si personalitet, ka një strukturë të veçantë psikike e cila që nga lindja e deri në vdekje ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij. Varësisht se si është zhvilluar, formuar dhe kultivuar personaliteti gjatë jetës së tij, baza psikike ka ndikim dhe reflektohet në sjellje dhe veprimet e tij. Bota shpirtërore e psikike e njeriut, është komplekse, e nduarnduarshme. Në shumë raste, disa veprime dhe sjellje të individëve nuk mund të kuptohen në shikim të pare. Ato nuk mund të ndriçohen pa u analizuar personaliteti dhe struktura e tij psikike. Kjo nuk do të thotë asesi se veprimet dhe sjelljet e individëve janë të determinuara kryekëput nga bota shpirtërore dhe psikike.

Njeriu, si personalitet paraqet një strukturë të veçantë. Bota e tij e brendshme, bota psikike, ka rëndësi të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale.

Pikërisht, sjelljet devijante, më konkretisht vrasësit serik dhe vrasjet serike do të shtjellohen në këtë temë magjistratura, duke u fokusuar më konkretisht mbi fenomenologjinë e vrasjeve serike, etiologjinë e të njetës , mbi faktorët që ndikojnë në kryerjen e vrasjeve serike. Një pasqyrë statistikore do të vë në pah prezencën e këtij lloj të devijimi kriminogjen që në fund të shtjellojmë raste studimi –case study në nivel botërorë dhe në Republikën e Maqedonisë.

Kapitulli 1

Aspektet juridiko-penale të veprës penale Vrasje

1. Aspektet juridiko-penale të veprës penale Vrasje

Jeta dhe integriteti truporë paraqesin vlera themelore njerëzore, sepse marrëdhëniet e përgjithshme sociale bazohen në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Për këtë arsye, ndryshe nga vendet tjera, Kodi Penal i Maqedonisë si kapitulli i parë në pjesën e veçantë është kreu që përmban krimet kundër jetës dhe trupit. Në këtë mënyrë, Maqedonia i vendos dhe i vërteton këto inkriminime si format më të rrezikshme dhe më të vështira në lëndimeve dhe rrezikimit të vlerave dhe intereseve të shtetit.

Me vrasje nënkuptojmë atë veprë të kundërligjshme, me anë të së cilës i meret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia.¹

Edhe pse bëhet fjalë për veprë penale e cila sipas kohës së shfaqes është e vjetër dhe në formë klasike, realiteti është më ndryshe. Vepra penale e vrasjes është shumë dinamike për këtë arsye edhe sot nuk ka humbur rëndësinë as në aspektin teorik dhe as në aspektin legjislativ apo krimonalopolitik. Më parë do të ishte pranuar ajo se vrasjet me praninë e tyre në çdo shoqëri, në shkallë të përhapjes që varion por askund nuk është i pa përfillshëm, dinamizmi dhe paqëndrueshmëria në aspektin e mënyrës së ekzekutimit, ekzekutimi më i shpeshtë i organizuar, vështirësitë dhe pengesat që dalin në zbulimin dhe ndjekjen e kryesve të tyre, turma e motiveve të ndryshme për të cilat ato kryhen, përfaqësojnë një delikt më të ri dhe më të përsosur të shoqërisë moderne.²

Me akuzimin e vrasjes si veprë penale mbrohet e drejta e jetës njerëzore, e cila e pranuar në përgjithësi konsiderohet në majën e piramidës së imagjinuar. Megjithatë, pavërsisht nga ky qëndrim, e drejta për jetë shkakton pasiguri të caktuara në lidhje me disa çështjem të tilla si nëse: ajo është një e drejtë e natyrshme e njeriut apo e fituar më vonë, vetë ekzistenca e njeriut si një krijesë dhe a ka ndonjë përjashtim nga kjo e drejtë e cila nëse legalizohet në legjislacion dhe cilat do ta relativizonin atë.³ Përpara se të shqyrtojmë vrasjen si veprë penale, është e nevojshme ti kushtohet vëmendje së pari dhe të kujtojmë disa pjesë të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, të cilat do të përpunohen në mënyrë analoge në konotacion të lëndës dhe do të na ndihmojnë pa dyshim në ndërhyrjen esenciale të zbulimit, formimit dhe lidhjes së të gjitha elementeve që e krijojnë vrasjen si një veprë penale.

¹ Zejneli Ismail, E drejta penale: pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq.19

²Kolaric Dragana, Krivicna dela ubistvade lege lata I de lege ferenda, Originalni naucni rad UDK: 343.61 (497.11), Kriminalisticko-policijska akademija, Beograd, fq. 2

³ Salihu Ismet, E drejta penale: Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq.39-42

1.1. Vrasjet e kualifikuara

Vrasja e kualifikuar përmban të gjitha elementet e formës bazë të vrasjes "së zakonshme", por dallohet prej saj, nga ajo se është kryer në rrethana të caktuara (kualifikuese) që rrisin ndjeshëm shkallën e paligjshmërisë dhe fajin e kryerësit, prandaj ligji parashikon mundësinë e shqiptimit të dënimit më të rëndë (burgim të përjetshëm). Në nenin 123, paragrafi 2. Pikat 1 deri 8 të KP të R.M.-së janë listuar disa rrethana të tilla me karakter të ndryshëm dhe janë të ndarë në disa grupe:

- mënyra e kryerjes së vrasjes: vrasje në mënyrë mizore ose tinëzare, vrasje gjatë dhunës në familje, vrasje gjatë kryerjes të së cilës vihet në rrezik edhe jeta e një personi tjetër.
- motivet dhe nxitjet e kryesit: vetë-interesimi, hakmarrja, fshehja e një vepre tjetër penale, porosia dhe heqja e organeve të viktimës, qeliza dhe inde për transplantim;
- karakteristikat specifike të viktimës: grua shtatzënë, fëmijë, person që kryen një funksion të caktuar psh. Gjyqtarë, avokat, prokuror publik ose person ushtarak;
- numri dhe pesha e vrasjeve të kryera;

Për tu vlerësuar nëse një vrasje është e rëndomtë ose e kualifikuar, si mjet përdoret metoda e eliminimit, domethënë nëse nuk ekziston ndonjë nga rrethanat e përshkruara më parë, vrasja do të konsiderohet si vrasje e rëndomtë, dmth formë themelore. Ndonjëherë, është e mundur për të kryer një vrasje që në vete konsumon më shumë kushte kualifikuese, për shembull. Vrasje e një personi me porosi që njëkohësisht është kryer në mënyrë mizore. Në këtë situatë egziston një vazhdimësi – alternativë, dmth. është një vepër penale- vrasje e rëndë, ndërsa rrethanat kualifikuese veprojnë si rrethana rënduese në përcaktimin e sanksionit.⁴

Për vrasjet e kualifikuara është paraparë dënimi me burgim në kohëzgjatje prej së paku dhjetë vitesh ose dënimi me burgim të përjetshëm.⁵

Vrasja në mënyrë mizore – Vrasja në mënyrë mizore karakterizohet me shkallën enorme të mundimeve dhe vuajtjeve fizike të viktimës. Dhimbjet fizike dhe psikike duhet t'i tejkalojnë ato dhembje dhe mundime që zakonisht shkaktohen me rastin e çdo vrasjeje. Për shembull, pasi kryerësi me sopatë ka prerë kokën e viktimës, ai vazhdon të coptojë në pjesë trupin e viktimës,

⁴ Kancev Metodija, Pregledna naucna statija UDK:343.611:340.13(497.7) –Kvalificirani (teski) ubistva, fq.156-158

⁵ Zejneli Ismail, E drejta penale: pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 21

ose pasi me një goditje në kokë ka alivanosur viktimën, kryerësi më pas i shkakton dhjetra goditje me thikë në trup.

Vrasje në mënyrë tinzare (dinake) – Ajo paraqet veprimin që në kuptimin objektiv dhe subjektiv i tejkalon suazat e fshehtësisë dhe dinakërisë të cilat rëndom shfaqen te vrasja me dashje. Një shembull klasik është situatë në mes dy personave që kanë lidhur kontratë për dhënie të mbështetjes së përjetëshme në të cilën dhënësi i mbështetjes duke abuzuar me besimin e marrësit të mbështetjes, i cili është një person i vjetër dhe i dobët gradualisht e helmon atë derisa të ndodhë pasoja e vdekjes.

Vrasje me dashje me ç'rast rrezikohet jeta e personave tjerë – Vrasje të këtilla konsiderohen kur kryerësi për të kryer v.p. përdor aso mjete ose vepron në aso rrethana me ç'rast vë në rrezik jetën edhe të ndonjë personi tjetër. Për shembull, eksplozivin, zjarrin, armët atomike që i përdor në tërësi ose kur shtie në drejtim të viktimës e cila gjendet në shoqëri me persona të tjerë p.sh. në rrugë ku ka kalimtarë, përkatësisht në ndonjë local me plot njerëz.

Vrasje për interes – Me këtë vepër nënkuptojmë pretendimin e paskrupullt egoist që gjithsesi të fitohet pasuri, Psh. Vëllau vret motrën e tij që më vonë fëmijët e tij të trashëgojnë në tërësi trashëgiminë. Së këndejmi, edhe ai që vret borxhliun e vet me qëllim që t'ia marrë të hollat dhe kështu të arkëtoj borxhin e vet, kryen vrasjen.

Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër – Vrasja e tillë egziston atëherë kur privimi nga jeta e personit tjetër është mjet për realizimin e donjë qëllimi tjetërm kryerjes së ndonjë veprë penale apo edhe fshehjen e veprës penale të kryer më herët. Në situatën e parë p.sh.kur dikush e vret rojtarin që më vonë të hyjë në ndërtesë, ose e vret burrin që më vonë ta përdhunojë gruan e tij. Situata e dytë egziston në rastet kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale e cila është kryer më parë (vrasja e dëshmitarit).

Vrasje nga hakmarrja e paskrupullt – Nocioni i përgjithshëm i vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt asocon në gjakmarrjen. KP-ja nocionin e paskrupullsisë e ndërlidh vetëm me hakmarrjen.

Vrasjet nga motivet e ulëta – Motive të ulëta në kuptimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë, konsiderohen ato motive që janë në kundërshtim të rreptë me rregullat ekzistuese social-etike dhe për to kryesi qortohet ashpër në aspektin moral, p.sh vrasje me qëllim të eliminimit të konkurentit për punë ose në ndonjë garë.

Vrasje në bazë të porosisë – Bëhet fjalë për vrasje të organizuar, në realizimin e së cilës marrin pjesë së paku dy persona: personi që porosity (porositësi) dhe kryerësi i drejtpërdrejtë. Përveç vrasjes së paguar, pas kësaj vrasje të kualifikuar mund të qëndrojnë edhe motive dhe lidhje tjera të kryerësit dhe porositësit, siç mund të jenë, lidhjet politikem ekonomike etj.

Vrasja e gruas shtatëzënë – Vrasja fiton llojin e kualifikuar për shkak të kumulimit të dy të pa drejtave, të krijuara me marrjen e dy jetërave: jetës aktuale (të gruas shtatëzënë) dhe jetës së ardhshme (foshnjës). Pra bëhet fjalë për vrasje të dyfishtë.⁶

1.2. Vrasjet e privileguara

Edhe pse rreziku social për kryerjen e veprës penale vrasje është padyshim i madh, egzistojnë rrethana objective-subjektive që ndikojnë në uljen e nivelit të rrezikut shoqërorë të këtyre krimeve. Gjegjesisht, ekzistenca e këtyre rrethanave siç janë afekti, çrregullime në lindje, mëshirë dhe neglizhencë, e ulin rrezikun shoqërorë të vrasjeve individuale, që kontribuojnë në kualifikime të ndryshme juridiko penale. Është një fakt i pamohueshëm se privimi i jetës së një njeriu sidoqoft paraqet shkeljen më të lartë të të drejtave të njeriut dhe për një veprim të tillë duhet të jepet llogari para ligjit dhe drejtësisë, por shteti a vendosur vrasjet e privileguara ti shikojë nga një perspektivë pak më të ndryshme. Kjo do të thotë një rrethanë lehtësuese për kryerësin që automatikisht çon në një dënim më të lehtë (krahasuar me vrasjet e rëndomta dhe të kualifikuara) për shkak të disa situatave të jetës që shkojnë përtej kontrollit në të cilin kryerësi nuk di të sillet ose nuk mund t'i kontrollojë ato në përputhje me parimin " nuk ka njeri që nuk ka mëkat. "⁷

Sipas pikpamjes komparative të ekspozuar më lartë, mund të konkludojmë që nuk ekzistojnë dallime drastike në kualifikimin e vrasjes dhe formave të saj të kualifikuara dhe të privileguara, as edhe në dallime të mëdha në aspektin e sanksionimit në Kodin Penal të Maqedonisë. Në përgjithësi, forma themelore e vrasjes është specifikuar pothuajse në mënyrë identike në Kodet Penale të përmendura në këtë punim, me dallime të vogla në dënimin minimal me burg, dhe e

⁶ Shih më gjerë Zejneli Ismail, Edrejta penale: pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 20-25

⁷ Sulejmanov Zoran, Ubistvata vo Makedonija, Skopje, 1995, fq. 75-80

njejta vlen edhe për format e kualifikuara për afërsisht me dënime të larta që përfshihen në diapazon të minimumit 8-10 vjet burg dhe burgim i përjetëshëm. Konsiderojmë se zgjedhje të tilla janë vendosur mire duke pasur parasysh peshën e krimit dhe pasojat e saj si edhe rrethanat tjera. Kur bëhet fjalë për forma të privileguara, ka dallime në faktin se në disa vende, si Zvicra dhe Gjermania, përveç burgosjes parashihen edhe gjrobat. Në këtë kontekst, meqenëse është një çështje me pasojë vdekje që paraqesin dëm të pariparueshëm pa marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat ato zbatohen, konsiderojmë se Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë del në prag me vendime më të mira, sepse nuk vendos gjobë si mjet dënimi, gjë që nuk paraqet përgjigje të drejtë ndaj një krimi që merr jetën një personi.⁸

Për shkak të rrethanave veçanërisht lehtësuese në të cilat kryhen disa vrasje, ato në të drejtat penale bashkëkohore konsiderohen si të privileguara, përkatësisht forma të lehta të vrasjeve.

Vrasje nga motive fisnike – Eutanazia – Dhënia e ndihmës në vdekja, vdekja e butë, përkatësisht vdekja e butë dhe e lehtë ka të bëjë me situatat e nryshme: vrasja e personit të sëmurë të pa shërueshëm që nuk ka shpëtim dhe është duke vdekur – që ti zvoglohen dhimbjet gjatë vdekjes; vdekja nga mëshira e personit që është i sëmurë dhe i pa shpresë për tu shëruar edhe pse nuk vdes- që t'i shkurtohen mundimet dhe të çohet deri te vdekja e shpejtë dhe pa dhimbje; shkurtimi nga mëshira e një jete të pa vlefshme, siç është, vrasja e personit të pa aftë për punë.

Vrasje në afekt – e cila në literature quhet edhe vrasje e provokuar, është privim i jetës së personit tjetër nga ana e personit, i cili pa fajin e tij është vënë në një tronditje të forte psikike për shkak të sulmit ose fyerjes së rëndë nga ana e të vërtetë.

Vrasja nga pakujdesia – konsiderohet se është kryer nëse dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryesit të veprës penale. Për shembull, kryerësi gjendet në pyllë pas një marrëveshje paraprake me viktimës për të gjuajtur. Duke pritur pritë në një distancë të madhe dhe duke menduar se bëhet fjalë për gjallesë që është object i gjyetisë, kryerësi pa asnjë siguri paraprake se nuk bëhej fjalë për qenie njerzore, duke vënë re një lëvizje gjuajti një predhë nga një pushkë gjuetie dhe goditi viktimën pa çka si pasojë shkaktoi vdekje.

Vrasja e foshnjës gjatë lindjes – kjo formë e vrasjes së privileguar qëndron në privimin e fëmijës nga jeta nga ana e nënës së tij gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, gjersa zgjasin çrregullimet e shkaktura nga lindja.⁹

⁸ Ibid;

⁹ Shih më gjerë Zejneli Ismail, Edrejta penale: pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 25-28

1.3. Aspekt krahasues i vrasjes si vepër penale

1.3.1. Republika e Sërbisë

Struktura e Kodit Penal të Republikës së Serbisë është shumë e ngjashme me versionin maqedonas. Pjesa e veçantë, si në vendin tonë, fillon me krimet kundër jetës dhe trupit. Ligjvënësi vrasjen e dënon me denim me burg prej 5 deri në 15 vjet. Llojet e vrasjeve të kualifikuara të përfshira në nenin 114 në termin "vrasje", që janë pothuajse identike me Kodin Penal të Maqedonisë janë të dënueshme me burgim prej së paku 10 vjet ose me burgim nga 30 deri 40 vjet. Sa u përket formave të privileguara siç janë vrasjet në çast, vrasja e fëmijës në lindje, vrasje nga neglizhenca, privimi nga jeta për shkak të mëshirës, shtytja dhe ndihma në vetëvrasje dënohen me denim me burg nga 1 deri 8 vjet dhe në shumicën e rasteve nga 6 muaj deri 5 vjet.¹⁰

1.3.2. Republika e Shqipërisë

Struktura e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është gjithashtu e ngjajshme me atë të Republikës së Maqedonisë . Pjesa e veçantë, në kreun e dytë përfshin veprat penale kundër personit, krime kundër jetës. Në seksionin 1 i titulluar ndryshe Krime kundër jetës të kryera me dashje ku përfshin Vrasjen me dashje ku dënimi parashihet gjer në 20 vjet burgim. Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga 15 gjer 25 vjet. Vrasja e kryer për interes, hakmarrje e gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, ose dhe me gjobë nga pesëqind mijë lekë deri në tre milion lekë. Vrasje në rrethana të tjera cilësuese dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.¹¹

¹⁰ Krivicni zakonik, Sl.Glasnik RS br. 85-2005-111

¹¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, online available http://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf 17.07.2018

1.3.3. Mbretëria e Suedisë

Suedia është monarki kushtetuese e bazuar në sistemin parlamentar të qeverisjes dhe dihet se ka një nga ekonomitë më të zhvilluara në Evropë. Kjo drejtpërdrejtë nkupton sistemin e drejtësisë kriminale të vendit në mënyrë që statistikisht tregojnë se nëpërgjithësi vendet skandinave kanë një normë më të ulët të recidivizmit dhe kryerjes së krimeve. Lidhur me vrasjen si çështje shqetësuese, Kodi Kriminal i Suedisë fillon pjesën e dytë pikërisht me krimet kundër jetës dhe shëndetit. Forma themelore e vrasjes si një krim dënohet me burgim nga 10 vjet burgim të përjetshëm. Duke marrë shembullin e SHBA-ve, në Suedi nuk është një lloj i veçantë i vrasjes që është në fakt forma e privilegjua rshkalla e të cilit e pahijshme dhe rrezikimin e mbrojtura me ligj i mire është më i vogël dhe mbulondisa situata. Kjo është një e ashtuquajtur vrasje pa dhunë ose vrasje pa ndonjë qëllim të keq (vrasje). E njëjta gjë mund të jetë vullnetare apo i pavullnetshëm, kështu që në pamjen e pare që mbulon një vrasje të kryer me provokim, në një moment tërbimi, zemërimi, dëshpërimi dhe zemërim i (diçka si vrasjen e momentit), ndërsa forma e dytë përfshin vrasjen e kryer për shkak të marrjes së paarsyeshme një shkallë të lartë rreziku ose vrasjeje të kryer gjatë një kundërvajtje. Për shkak të mungesës së qëllimeve dhe rrethanave me qëllim të keq, ligji suedez dënon këtë veprë me një dënim me burg prej 6 deri në 10 vjet. Për shkak të mungesës së qëllimeve dhe rrethanave me qëllim të keq, ligji suedez dënon këtë veprë me një dënim me burg prej 6 deri në 10 vjet.¹²

1.3.4. Republika e Kosovës

Si edhe legjislacionet e cekura më sipër ashtu edhe legjislacioni i Republikës së Kosovës i kushton një mbrojtje juridiko – penale të posaçme trupit dhe jetës së njeriut, nëpërmjet penalizimit dhe sanksionimit në Kodin Penal të të gjithë atyre veprave shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme që drejtohen kundër njeriut. Një mrojtje e tillë përfshihet konkretisht të kapitullin e XVI i titulluar Veprat penale kundër jetës dhe trupit.

¹² Kodi Penal i Suedisë online available

<https://www.government.se/contentassets/5315d27076c942019828d6c36521696e/swedish-penal-code.pdf>
18.07.2018

Veprat penale kundër jetës dhe trupit përfaqësojnë veprat penale që mbartin rrezikshmërinë shoqërore më të lartë. Në legjislacionin Kosovar, parashikohen disa lloje e figura të ndryshme të veprës penale të vrasjes, si për shembull, vrasje e ashtuquajtur "e thjeshtë", vrasja e rëndë që kryhet në rrethana të cilësuar, vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, vrasja nga pakujdesia apo vrasja e foshnjës nga nëna;

Vrasja “e thjeshtë” (vrasja e konsideruar e tillë duke qenë se nuk kryhet në rrethana të cilësuar) dënohet sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me burgim deri në pesë vjet.

Me vrasje të rëndë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës do të konsiderojmë vrasjen e kryer në rrethana të cilësuar, veprë penale për të cilën parashikohet një dënim me burgim të përjetshëm ose jo më pak se dhjetë vjet për personin i cili: 1) privon nga jeta fëmijën; 2) privon nga jeta femrën shtatzënë; 3) privon nga jeta anëtarin e familjes; 4) privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake; 5) privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave të tjerë; 6) privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore; 7) privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë 8) veprë tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale; 9) privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale; 10) privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare; 11) privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare; 12) me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi; 13) privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi.¹³

¹³<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>, 08.10.2018

Kapitulli 2

Fenomenologjia e vrasjeve serike

2. Fenomenologjia e vrasjeve serike

Me çështjen e fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë. Pjesa më e madhe e tyre që e kanë trajtuar problemin e fenomenologjisë kriminale, theksojnë se ajo është shkenca mbi manifestimin e krimit. Kësisoj, këta autorë vërtetojnë se fenomenologjia kriminale duhet të koncentrohet në studimin e statikës, dinamikës dhe tipologjisë së formave të manifestimit të krimit dhe sjelljeve delikvente. Po ashtu, sipas tyre, ajo duhet të merret edhe me përshkrimin e mënyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit të kryerësve respektivisht me studimin e jetës së delikuentëve dhe, në fund, me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve.¹⁴

Këndvështrimi ynë mbi problemin e vrasjeve serike do të përcaktonte atë çka ne kërkojmë. Ndërgjegjja e njerëzimit kërkon që të shpjegohet marrja e një jete njerëzore nga një tjetër.¹⁵ Qeniet njerëzore dallohen nga format e tjera të gjallesave në kuptim të aftësisë së tyre për të zhvilluar kulturën. Të nënkuptuarit e këtij nocioni është shoqëria jonë. Qeniet njerëzore kanë, menjëherë, aftësinë për të vepruar në mënyrë prosociale dhe antisociale- dy dimensione që nuk janë reciprokisht ekskluzive. Në të vërtetë, kjo mund të jetë rezultat i motiveve mbrojtëse ose humanitare që nxisin një individ për të vrarë një tjetër. Veprimi i marrjes së jetës së tjetrit mund të jetë kështu i kuptueshëm - dhe i pranueshëm - në kuptimin e dobisë së saj të dukshme.¹⁶

Vrasja nuk përfshin gjithmonë akte kriminale, të dhunshme, agresive apo me dashje. Vrasja e dikujt në vetëmbrojtje ose në kontekstin e luftës janë shembuj të vrasjeve të kuptueshme. Megjithatë, ekzistojnë lloje të tjera vrasjesh për të cilat nuk mund të përshkruhet një mirëkuptim dhe pranim i tillë. Vrasja serike qëndron si një shembull i dukshëm në këtë drejtim. Nga çka qëndron në këtë rast motivimi për të vrarë vazhdimisht?

A janë vrasësit serik ato që vrasin një numër njerëzish me kalimin e kohës, para së gjithash për kënaqësi personale – njerëzit e zakonshëm që bëjnë vepra të jashtzakonshme? A ka diçka thelbësisht të papërshtatshme për atë që i udhëheq për të vrarë në mënyrë të përsëritur? Në secilin rast, vrasjet serike që ata kryejnë janë dëshmi për zgjuarsinë, mizorinë dhe vetë-

¹⁴ Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë: Universiteti Fama, 2007, fq. 115

¹⁵ Shih më gjerë Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë: Universiteti Fama, 2007, fq. 126

¹⁶ Egger, S. A. (1990). Serial murder: An elusive phenomenon. New York: Praeger.,fq.350-358

kënaqësinë e tyre, secila, aspekt i gjendjes njerëzore.¹⁷ Ndërsa do të intervistonim një person që ka vrarë, do të impresionoheshim nga shumë gjëra: llojin e intelektit dhe personalitetit që secili prej tyre zotëron, ndjenjën e humorit të tyre, rendin e tyre të dukshëm. Ata hanë mëngjes si ne të tjerët. Por, menjëherë është realiteti i krimeve që ato i kanë kryer.¹⁸

2.1. Etiologjia e vrasjeve serike

Etiologjia kriminale ose faktorët mbi kriminalitetin kanë të bëjnë me njohjen e burimeve, rrënjëve dhe rrethanave përcaktuese të kriminalitetit. Etiologjia kriminale analizon dhe studion lidhjet kauzale në mes të rrethanave e faktorëve të ndryshëm dhe kriminalitetit. Po ashtu etiologjia kriminale studion dhe bënë hulumtimin e shkaqeve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të gjitha sjelljet kriminale dhe dukuritë tjera negative në shoqëri.

Studimet etiologjike merren me faktorët objektivë-ekzogjen dhe subjektivë- endogjen të cilët e kushtëzojnë fenomenin e kriminalitetit dhe dukurive të tjera antisociale dhe negative në një shoqëri. Në këtë mënyrë etiologjia kriminale angazhohet për njohjen, zbardhjen dhe të kuptuarit e proceseve të cilat ndikojnë në formimin negativ të personalitetit dhe shpien deri te aktiviteti i tij kriminal. Pra, etiologjia kriminale angazhohet për shpjegimin dhe ndriçimin e rrugëve të cilat shpien deri te kriminaliteti.¹⁹

Kur bëhet fjalë për etiologjinë e vrasjeve serike, duhet te theksohet se ekzistojnë shumë hulumtime kriminologjike dhe teori të ndryshme si ajo biologjike, sociologjike, psikologjike dhe psikiatrike që përpiqen të shpjegojnë arsyet për këtë formë specifike dhe sjellje të dhunëshme ekstreme.²⁰ Përveç kësaj, janë bërë përpjekje për të konturuar profilin e vrasësit serik, kështu që në pjesën e mëtejshme të këtij punimi master do të përpunohen pikërisht këto pjesë të këtij fenomeni që janë thelbësore në shpjegimin e tij.

¹⁷ Egger, S. A. (1998). *The killers among us: An examination of serial murder and its investigation*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall., fq. 130-145

¹⁸ Fox, J. A., & Levin, J. (1994). *Overkill: Mass murder and serial killing exposed*. New York: Plenum.fq. 96-104

¹⁹ Halili Ragip, *Kriminologjia*, Prishtinë: Universiteti Fama, 2007, fq. 235-236

²⁰Elvira Natour, Anita Jandric, *Etiologjia serijskih ubojstava*, 2006, fq. 51

Termi vrasës serik është një monedhë angleze she i atribohet ish agjentit të FBI-së, Robert Resler gjatë viteve 1970. Koncepti u zbulua edhe më parë nga inspektori gjerman i policisë Ernst Genat në vitet 1930.²¹

Etiologjia e vrasjeve serike i referohet dëshirës për vetë pushtet që rrjeth nga vetë natyra. Në fakt, ato synojnë dëshirën për mbijetesën e më të fortëve, madje edhe në kurriz të të dobëtve, dhe kjo është specifike për të gjitha llojet e gjallesave, duke përfshirë edhe njerëzit. Rezultatet e eksperimenteve të caktuara me kafshë mund të jenë mjaft të rëndësishme për studimin e vrasjeve serike: minjtë të cilët në luftë triumfojnë më vonë do të përpiqen që përsëri të fillojnë luftë, përderisa ato që e kanë humbur luftën do të përpiqen që ta shmangin të njëjtën. Paralelisht, nëse vrasja e parë ka sjellë kënaqësi, vrasësi do të dojë që të vazhdojë të vrasë dhe anasjelltas. Vrasja serike është një operacion kompleks dhe në vete përmban gjurmë të disa veprimeve të ndërmarra që janë në shumicën e rasteve të organizuara mirë, të planifikuara dhe të strukturuar në një skemë që, sapo të vërtetohet e sukseshme, vrasësi pastaj e përdor atë vazhdimisht sepse përmbush qëllimin e tij, ndërsa në të njëjtën kohë e mbulon identitetin e vet.²²

2.2. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e vrasjeve serike

Para se të përqëndrohemi më shumë tek teoritë, duhet të themi më shumë për faktorët e përgjithëm që ndikojnë në kryerjen e vrasjeve serike. Pra, për shpjegimin e tyre është e nevojshme t'iu jepet përgjigje disa pyetjeve të tilla si: kush, ku dhe pse vrasin, përgjigjja e të cilave pyetje nuk mund të jepet pa marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Biologjike – që strehon predispozicionin gjenetik, dëmtime eventuale të kokës, funksion anormal të sistemit endokrin (çrregullim të punës së gjëndrave gjatë tajimit të hormoneve) dhe ngjajshëm;
- Psikologjik-psikiatrik- të cilat përfshijnë një lloj të caktuar të psikozës, depresionit, psikopatisë, traumës, skizofrenisë, etj;

²¹ C. Kluckhohn, H. Murray, & D. Schneider (Eds.), *Personality in nature, society, and culture* New York: Knopf, fq. 53-67

²² Ibid;

- Sociologjike – këto duhet t'u përgjigjen çështjeve të tjera të tilla si pse në disa shoqëri ekzistojnë më shumë vrasës serik se sa në disa vende tjera, përse shoqëritë e ndryshme reagojnë ndaj vrasjeve serike në një mënyrë tjetër, pse përqindja e vrasjeve serike në të njëjtin ambient shoqëror ndryshon me kalimin e kohës dhe ngjajshëm.²³

Një grup autorësh konsideron se për të kuptuar vrasjet serike duhet që si pikënisje të merren karakteristikat personale të kryesve edhe pse nuk është aspak e lehtë të njëjtat të përcaktohen. Megjithatë, konsiderohet që duhet të pëfshihen forma të sjelljeve antisocialo agresive dhe joshoqërore, tendenca e shmangieve të vazhdueshme për të zhvilluar marrëdhënie më të ngushta me njerëz të tjerë, dhe me të vërtetë ka disa vrasës serik që janë në kontrast të plotë me këto (psh. Karakteri letrar i Xhekil dhe Hajd i cili vrasjet i kryen gjatë natës, ndërsa gjatë ditës është një qytetarë i nderuar dhe i respektuar).²⁴

Për shkak të kësaj situate, për të kuptuar vrasësit serik është e nevojshme që të depërtojmë pak më shumë në prikopatologjinë. Për njohësit e kësaj çështje, termi "psikopat" është më i përshtatshëm për përdorim. Sipas këtij termi, psikopati përkufizohet si një person antisocialm agresiv dhe shumë impulsiv, i cili nuk ndjen fare brejtje të ndërgjegjes për veprimet e veta dhe nuk është në gjendje të krijojë një marrëdhënie emocionale afektive me njerëzit e tjerë. Autorë të tjerë i shtojnë karakteristikat në kënaqësinë e dhunës predatore, e cila shpesh ka vija të hakmarrjes, gjithashtu gjakftohtësi dhe sofistikim në kryerjen e veprave të vrasjes.

Gjithashtu, shpesh mbahet qëndrimi që kriminogjeneza vrasjeve serike fillon në fëmijërinë e hershme. Në literaturë potencohet që duhet të kushtohet vëmendje në atë lloj të fëmijëve që shpesh urinojnë në krevat, krijojnë shprehitë e vetë-lëndimit (prerje, mavijosje, etj), tregojnë agresivitet ndaj kafshëve dhe miqëve të tyre/shokëve të klasës dhe nuk duan kontakte sociale gjegjësisht tërhiqen në vetëvete.

Më shpesh këta fëmijë rrjedhin nga familje disfunkcionale dhe janë subjekt i abuzimeve fizike dhe psikologjike. Kur është fjala për këtë temë, megjithatë, tregon se ka fëmijë të cilët kanë këtë lloj të karakteristikave d.m.th. agresivë dhe manipulues, nuk duan të pranojnë fajin dhe përgjegjësinë, dhe megjithatë nuk bëhen vrasës serik, por kur flasim për trauma psiko-fizike kjo

²³ Biagi – Chai Francesca, Serial Killers Psychiatry, Criminology, Responsibility(Routledge 1 edition), 2012., fq. 910-913

²⁴ Kocsis Richard, Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes, Humana Press New York, USA, 2008.fq.705

tashmë merr më shumë peshë, sepse psikologët konsidrojnë që kryesisht në vitet e mëvonshme të jetës, personi i traumatizuar, frikën e tij, pakënaqësitë dhe kompleksët do t'i hedhi në sipërfaqe në një farë mënyre.²⁵

Një faktor tjetër i cili ka ndikim sipas autorëve të caktuar, është ambienti shoqërorë dhe teoria e të mësuarit shoqëror. Ndër vrasësit serik ka edhe të atillë që më parë kanë kaluar trajnime ushtarake, kështu që përmes përmes një mënyre të tillë të jetesës ata kanë mësuar edhe sjelljet agresive, madje edhe privimi nga jeta të tjerët. Konsiderohet se duhet të ketë një seksion të veçantë në shkencë që lidhet me forcat e armatosura të cilët nëpërmjet trajnimeve dhe veprimeve ushtarake i lënë pritjet e arsyeshme dhe vlerat morale, dhe për këtë arsye bëhen "makina për vrasje".²⁶

Duke folur për ndikimin sociologjik, duhet që ndalemi edhe në dy momente: akooli dhe droga, si disa nga veset më të këqija dhe shfaqje e madhe e materialeve pornografike dhe përmbajtjes së dhunshme në media. Lidhur me të parën, debatohet nëse vërtetë konsumi i tyre çon në ekzekutimin e krimit apo vetëm ndihmon kryerësit të inkurajohen për tejkalimin e pengesave gjatë kryerjes së veprës së vrasjes, ndërsa psikologët kapen për faktit se gjatë gjenezës së vrasjes kryerësi duhet së pari të depersonalizojë viktimën dhe ta njësojë atë me statusin e një objekti. Është përmbajtja e dhunshme që vazhdimisht promovon vuajtjet njerëzore dhe e paraqet atë si diçka e zakonshme dhe normale. Në mënyrë të ngjajshme, është argumentuar përmbajtja pronografike, në të cilën ka gjurmë të dhunës, poshtërimin dhe degradimit total të personit, në mënyrë që akti normal seksual të kthehet në diçka të shtrembëruar dhe të panatyrshme.²⁷

Përmbledhur, stresi është pjesë e pandashme e jetës së përditshme dhe çdo person përshtatet ndryshe në të. Ato që janë më të prekshëm nën ndikim e tij mund të ndjehen të ekspozuar, të hutuar, të refuzuar dhe të nënshtuar, kështu që nuk mund të përshtaten. Një vrasës serik në evoluim për ndonjë arsye e ekzagjeron fajin e ndjenjës së tij të ankthit dhe përdor sulme ndaj të tjerëve si një mënyrë për të rivendosur ose mbajtur vetëbesimin. Duke u përpjekur të krijojnë një ekuilibër psikologjik që u është privuar nga njerëz me ndikim, vrasësit serik (kriminelët) ndërtojnë maska, fasada të vetëvlersimit dhe vetëkontrollit.²⁸

²⁵ WallerS. Serial Killers Philosophy for everyone, Being and killing, Blackwell edition, 2010. fq. 99

²⁶ Ibid;

²⁷ Shih gjithashtu më gjerë mbi pikpamjet e faktorëve kriminogjen Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë: Universiteti Fama, 2007, fq. 236-240

²⁸ Egger, S. A. (1990). Serial murder: An elusive phenomenon. New York: Praeger. 264-265

2.3. Pasqyrë krahasuese e vrasësve serik të gjinisë femërore dhe mashkullore

Gratë janë rrallë herë autorë, kriminelë, ata më së shpeshti marrin rolin e viktimave. Në përgjithësi, kjo është më lehtë për tu pranuar për arsye që tradicioni, normat kulturoro-shoqërore dhe ato zakonore gratë i portretizojnë si një krijesë të butë, të kujdesshme, të qetë, me një instikt të nënës, fizikisht inferior ndaj burrave, prej të cilave nuk pritet agresivitet, dhunë, tregimi i fuqisë dhe dominancës, ashtu siç përmendet më lart, epitete të tilla modeli patriarkal ua shton meshkujve.

Me emancipimin e grave dhe duke rritur ndërgjegjësimin e tyre, filloi procesi i përqëndrimit tek ata si kriminelë të mundshëm, dhe në këtë kontekst u regjistruan ngjajshmëri dhe dallime të caktura në "skicën" e vrasjeve serike të të dy gjinive.

Së pari, vrasësi serial femëror pritet të jetë më pak i dhunshëm dhe më i matur se gjinia mashkullore, prandaj krimet e saj janë më pak të dukshme në komunitetet sesa ato të burrave. Për më tepër, vdekja e viktimave nga vrasësit femra rrallë shkaktojnë vëmendje tek publiku dhe si metoda më të zakonshme e vrasjes është helmimi. Vrasësit serik meshkuj janë ato që përdorin më shpesh metoda të dhunshme vrasëse, për shembull therje, masakrim etj, ndërkohë që gratë rrallë në mënyrë të tillë kalojnë rezistencën e viktimës. Në të kundërtën, një vrasës serik femëror së pari fiton besimin e viktimës për të gjetur më vonë pikën e dobët të saj dhe për të abuzuar me te, ndërsa meshkujt e përdorin mungesën e forcës fizike si një dobësi primare.²⁹

Një dallim tjetër midis vrasësve serial të gjinisë femërore dhe mashkullore është nevoja e zhvendosje. Gratë nuk kanë nevojë të ndryshojnë vendndodhjen e tyre aq sa meshkujt në këtë klasë të kryerësve. Kjo është kështu sepse femra tërheq më pak vëmendje ndaj saj dhe vdekjes së viktimës. Vrasjet që i kryejnë nuk janë aq të dukshme. Shpesh mund të shpjegojë në mënyrë efektive zhdukjen e papritur të një personi nga perspektiva konfidenciale për dikend me te cilin ka kontakte të ngushta. Meshkujt nga ana tjetër kanë më shumë gjasa të vrasin në komunitete të ndryshme, qytete, shtete ose provinca të ndryshme nëse dëshiron të shmangë vëmendjen e padëshiruar.³⁰

²⁹Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes, edited by N. KocsisRichard, Humana Press New York, USA, 2008, fq. 191-192

³⁰ Ibid;

Vrasjet serike të kryera nga gratë shpesh shoqërohen me krime sekondare të tilla si, për shembull vjedhje, mashtrime etj, ndërsa ato të kryera nga burrat janë më së shumti të shoqëruar nga një sulm seksual.

Kur bëhet fjalë për ngjajshmëritë midis vrasësve serial të të dy gjinive, përmenden si në vijim: edhe tek njërit edhe tek tjetrit plani për të rënë në kurthë gjithmonë bëhet aty ku vrasësi ka një avantazh (meshkujt më së shumti e joshin viktimën në vende të shumta, ndërkohë që femrat kryesisht në një apo dy, por në të dyja situatat viktima përzgjidhet në një mënyrë që do të jetë një lloj prezantimi i vrasësit).

Motivet, pavarësisht nga gjinia e vrasësit, janë gjithmonë personale dhe të pagjohura për masën e gjërë.³¹

2.4. Tipologjia e vrasësve serik

Meqë fokusi i këtij hulumtimi janë vrasjet serike, është interesante të përmendet tipologjia e vrasësve serialë. Bëhet fjalë për tipologjitë e disa autorëve, sipas Holmes dhe De Berger, ekzistojnë 4 lloje të vrasësve serialë, edhe atë:

- Vizionarë (Zoti dëshiron të eliminojë të keqen);
- misionarë (dua të lëroj botën nga prostitutat etj);
- hedonistë (për shkak të ndjenjës së kënaqësisë që sjell vrasja me të);
- për shkak të dëshirës për pushtet (ndjenja e dominimit).

Gjithashtu, sipas hulumtimeve përkatëse nga autorët e tjerë dhe dokumente të tjera mund të kryejmë një lloj tjetër tipologjie që vrasësit serik i vendosin në kategoritë e mëposhtme:

- Sëmundje mendore (hallucinacione, paranojë, skizofreni etj.)
- vrasësit serikë të paguar (fitimi është qëllimi dhe motivimi kryesor);
- sadistët seksualë (frustrimi seksual, abuzimi seksual);
- të varur nga substancat psikotrope (të varur nga drogat dhe alkoolistët);

Udhëzuesi kriminalistik për zbulimin e vrasësit, ndërtimi i profilit të tij, si dhe përcaktimi i verzioneve dhe viktimave të mundshme është skena e krimit. Këtu luan rol ndarja e vrasjeve

³¹ Ibid;

serike në të organizuara dhe të paorganizuara. Vrasësi i organizuar është një person shumë inteligjent dhe i adaptuar në mënyrë shoqërore. Skena sugjeron se rasti ka qenë mire i planifikuar dhe i përgatitur më herët, më sakt i inscenuar në fantazinë e kryerësit, udhëtimi më parë në vendin e ngjarjes, mbajtja e një arme të zgjedhur me kujdes, zgjedhja me kujdes e viktimës etj. Përveç kësaj, mjaft shpesh trupi i viktimës lihet në pozita të posaçme të zgjedhura ose të fshehura mire në mënyrë që kryerësi të japë ndonjë mesazh. Për dallim nga kjo, vrasësi i paorganizuar zakonisht është me intelegjencë të ulët dhe socialisht i papërshtatshëm. Skena sugjeron se kryesi vrau viktimën në mënyrë të befasuar, me armë që ju është gjendur, më tej vendi i ngjarjes është zakonisht në afërsi të vendbanimit ose vendqëndrimit të vrasësit dhe i njejtë nuk shqetësohet që të fshehë kufomën apo ta pastrojë nga ndonjë gjurmë, kështu që çdo gjë në skenën e krimit është kaotike. Kjo ndarje, përveç të ky lloji i krimit, përdoret gjithashtu në lloje të tjera të krimeve të dhunshme, për shembull, zjarrvënie (piromania).³²

Nuk ka ndonjë përkufizim të pranueshëm për vrasjet serike, por më i përgjithshëm merret ai që mes vrasjeve duhet të ketë një "periudhë të ftohtë", në të cilën vrasësi kamuflohet gjegjësisht zhduket jashtë radarit, që pas një periudhe kohore përsëri të sulmojë viktimën e ardhëshme. Kjo periudhë lëviz në interval të ndryshme kohore, në varësi të kënaqësisë dhe motivimit të vrasësit dhe gatishmërisë së tij. Përveç periudhës për të nxjerrë një pasqyrë të përgjithshme të autorëve të vrasjeve serike si lidhje e dytë merret numri i vrasësve që janë të nevojshme për një person të caktuar për t'u kualifikuar si vrasës serial. Disa konsiderojnë se 4-5 vrasje janë të nevojshme dhe disa besojnë se edhe një vrasje mund ta plotësojë kriterin, sepse është e mundur që vrasësi të jetë nisur në udhëtim, por të themi se ai është provuar nga liria, kështu që është ndërprerë aksioni i mëtejshëm por motivi ekziston. Megjithatë, si numër më i pranueshëm për të etiketuar një vrasës serik si të tillë konsiderohen tre vrasje sepse ato janë të mjaftueshme që të përcaktohet skema e vendosur dhe të pasqyrohen lidhjet individuale.³³

FBI-ja e definon vrasjen serike si vrasje të shumë viktimave, të ndara në tre ose më shumë incidente në disa javë ose periudha më të gjata. Një tjetër nga përkufizimet më të pranueshme është ajo e Eger. Ai thotë: " Vrasja serioze është kur një ose më shumë persona kryejnë dy ose më shumë vrasje, viktimat dhe sulmuesit nuk janë të njohur me njëri-tjetrin dhe vrasjet ndodhin

³²PetherickWayne, Serial Crime – Theoretical and Practical Issues in Behavioral Profiling, USA, 2006, fq. 491

³³PetherickWayne, Serial Crime – Theoretical and Practical Issues in Behavioral Profiling, USA, 2006, fq. 180

përkohësisht në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe shpesh në vende të ndryshme gjeografike"³⁴

Në plan teorik vrasjeve serike u shtohen karakteristika të caktuara që i dallojnë ato nga llojet e tjera të vrasjeve. Së pari, vrasjet përsëriten, dmth. ndodhin në seri dhe në shumicën e rasteve vazhdojnë derisa vrasësi të jetë i privuar nga liria. Për më tepër, vrasësit serik zakonisht veprojnë vetëm dhe për këtë arsye është më e vështirë për ti zbuluar, edhe pse janë të evidentuar edhe vrasës serik që veprojnë në çifte (këtu bërja e gabimeve është më e zakonshme dhe për këtë arsye është më e lehtë tu zbulohen gjurmët). Zakonisht mes vrasësit dhe viktimës nuk ka asnjë kontakt personal më herët dhe për këtë arsye puna e organeve të ndjekjes është e vështirë sepse janë në kërkim të dikujt që "nuk ka motiv".

Tjetër, rritja e frekuencës së lëvizshmërisë në hapsirë në sajë të progresit të civilizimit (teknologjisë, transportit të zhvilluar etj), lejon vrasësit serial ta zgjerojnë aktivitetin kriminal në territory më të gjerë, dhe kjo çon në fragmentim dhe mungesë të koordinimit ndërmjet shërbimeve policore dhe inspektimit kështu që i ndihmon ata të shmangin heqjen e lirisë.

Një veçori e veçantë është se vrasjet janë shënuar me një shkallë të lartë të dhunës të cilat ekspertët e shoqërojnë me motivin për kryerjen e krimit. Përmes tij, jeta e personit tjetër zhvlersohet. Këtu, lidhet edhe mjete për kryerjen e veprës penale e cila shpesh është një object specific (çekiç, sopatë, komplet thikash, mjete të tjera të rënda, substance kimike etj.). Është karakteristike që shumica e vrasësve serik janë meshkuj dhe të racës së bardhë, ndërsa shumica e viktimave janë gra, kështu që disa autorë e lidhin këtë me maskulinitetin si sinonim për dhunën, dominimin, agresionin dhe autoritetin.³⁵

2.5. Tipologjia e vrasësve serik sipas Holmsit dhe De Berger (Holmes and De Berger)

Siç e kemi theksuar edhe më herët, ekzistojnë disa klasifikime të vrasësve serial që përpiqen të selektojnë ato sipas disa karakteristikave që ato tregojnë gjatë kryerjes së vrasjeve. Një nga

³⁴Elvira Natour, Anita Jandric, Etiologjia serijskih ubojstava, 2006, fq. 56

³⁵Hickey, E. W. (1997). Serial murderers and their victims (2nd ed.). Pacific Grove, CA: Brooks/Cole.fq.48-53

tipologjitë më të famshme është ajo e Holmes dhe De Bergger, e cila përbëhet nga 4 lloje vrasësish serial edhe atë:

-*vizionar* – këto vrasës serial vrasin si pasojë e halucinacioneve komanduese, iluzionet dhe vizionet burimet e të cilëve përfshijnë forcat e së mires dhe të keqes.³⁶ Karakterizohen me humbjen e kontaktit me realitetin dhe vrasin në emër të Perëndisë apo djallit.³⁷

Shpesh zërat e tillë që dëgjon vrasësi janë rezultat i një lloj sëmundje mendore, siç është skizofrenia dhe ngjajshëm. Në mënyrë tipike, ai zgjedh një viktimë të caktuar për arsye të ndryshme, për shembull gjinisë, kombësisë, races, moshës, profesionit dhe nuk është e pazakontë që skena kriminale ta lërë atë në kaos total. Vrasjet ndodhin shpejt, më së shpeshti pa ndonjë akt torture apo tjetër lloj keqtrajtimi ndaj viktimës, ndërsa si mjet për ekzekutim më së shpeshti përzgjedhet një armë që rastësisht gjendet në vetë situatën në vendin e krimit.

-*misionar*- ky lloj dallohet nga tipi vizionar në atë që zakonisht nuk vuan nga një psikoze, por udhëhiqet nga disa bindje të forta të drejtuara kundër një grupi të caktuar të njerëzve. Për shembull, mund të vrasë emigrantë, lypës, prostitute, individë të një race tjetër, homoseksualë dhe kështu me radhë. Në këtë mënyrë, ai konsideron që shoqëria do të pastrohet nga sëmundjet, trishtimi, devijimi ose patologjia, gjegjësisht nga humbjet që rrjedhin nga të varfërit, njerëz të një kombësie tjetër ose orientimi seksual etj.³⁸ Për më tepër, është karakteristike që vrasjet më së shpeshti janë të planifikuara, vrasësi nuk angazhohet në aktivitete shtesë pas vdekjes së viktimës dhe mjetet e ekzekutimit nuk janë të dukshme në vendin e ngjarjes.

-*hedonist* – kryerësi vret duke kërkuar ndonjë lloj kënaqësie me vdekjen e të tjerëve. Ky lloj ndahet edhe në disa nëntipe:

- *Vrasës që vret nga pasioni* – në parim ai vepron për kënaqësi seksuale dhe ngritje edhe pa një akt seksual tradicional. Sidoqoftë, mardheniet seksuale apo aktet sadistike-erotike me vektimën ende të gjallë janë të zakonshme. Orgazma ose sjellje të tjera seksuale emocionuese (p.sh. masturbimi) është forca shtyese e këtij autori devijant edhe pas vdekjes së viktimës. Për më tepër, ky sulmues- vrasës mund të ngacmohet seksualisht me vetë vrasjen e viktimës. Forma e

³⁶*Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes*, edited by N. KocsisRichard, Humana Press New York, USA, 2008, fq. 124

³⁷Repisti Selman, Originalni naucni rad, *Kriminalisticko profiliranje i fenomenologij amasovnih, nekontrolisanih i serijskih ubistava*, Sarajevo, Bosna I Hercegovina, 2016, fq.34

³⁸Ibid;

ritualit të gjymtimit, deformimi i fytyrës, kanibalizmi, dekompozimi i trupit, vampirizmi dhe nekrofilia kryhen në mënyrë rutinore në këtë lloj tipi vrasës.³⁹

-vrasës i cili vret nga ngazëllimi –ky vrasës vepron për shkak të eksitimit që përjeton. Sidoqoft, kur viktimja vdes, ai humbet interesin. Kjo është arsyeja pse procesi i vrasjes zgjat sa më shumë që të jetë e mundur përmes akteve të tregjaturave të torturës. Përdorimi i kufizimeve fizike, shfaqja e shenjave të kafshimit dhe djegjeve në trupin e viktimës janë sjellje karakteristike të këtij tipi të vrasësit. Aktet sadiste, frekuenca e së cilës zgjatet sa më shumë që është e mundur, trupi i viktimës i fshehur, asfikcion manual dhe një viktimë e animuar gjatë veprimeve të shumfishta seksuale janë shenjat dhe motivet e këtij lloji të vrasësit.⁴⁰

-konformist- bëhet fjalë për tip që është shumë më racional, vret për shkak të fitimit të pritur material dhe vrasësi i paguar është shmbulli më i mirë i këtij tipi të vrasësve serik.⁴¹

Karakteristike është që janë mjaft të përqëndruar gjatë vetë procesit të vrasjes, duke filluar me veprimet përgatitore deri në përmbushjen e misionit të tij.

-I varur nga kontrolli/ i etur për pushtet dhe dominim – ky kryes ka një ndjenjë me rrënjë të thella të paaftësisë apo përpiqet të kompenzojë mungesën e sundimit social dhe personal mbi veten e tij me anë të një dominimi të plotë të viktimave të tij. Sipas Holmes dhe DeBergger, motivi kryesorë për këtë kryes nuk është seksual nga natyra. Në fakt, ai dëshiron kontroll të plotë dhe të pakufizuar mbi viktimën dhe paraqitjen e tij (nuk përjashtohet nga kryerja e marrëdhënieve seksuale), duke përfshirë periudhën pas vdekjes së viktimës. Rrjedhimisht, tortura, përdorimi i kufizimeve fizike, mbytja, prerja e pjesëve të trupit, prerja e kokës, kryhen në mënyrë rutinore në këtë veprim vrasës. Ndjenja e thellë e gjithanshmërisë – fuqia absolute mbi jetën dhe vdekjen e viktimave ndërsa lypin për jetën e tyre është ajo që ushqen këtë vrasës serik. Rritja e numrit të vrasjeve rrit nivelin e kënaqësisë.⁴²

³⁹*Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes*, edited by N. KocsisRichard, Humana Press New York, USA, 2008, fq. 125

⁴⁰ Ibid;

⁴¹PetherickWayne, *Serial Crime – Theoretical and Practical Issues in Behavioral Profiling*, USA, 2006, fq.191

⁴²*Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes*, edited by N. KocsisRichard, Humana Press New York, USA, 2008, fq.125

Kapitulli 3

Të dhëna statistikore

3. Të dhëna statistikore

Përveç origjinës dhe shpjegimit teorik të vrasjeve serike, është e nevojshme të japim një pasqyrë se si ato manifestohen nga jashtë, dmth cilat janë modelet e tyre të paraqitjes, frekuenca, struktura, të dhënat demografike etj, karakteristika që do të ndihmojnë në hartimin e imazhit të tyre real dhe objektiv. Për këtë arsye, në vazhdim do të paraqesim statistika lidhur me vrasjet serike në nivel ndërkombëtarë, global , të dhëna statistikore për vrasjet serike në rajon e së fundmi edhe në Republikën e Maqedonisë.

3.1. Të dhëna statistikore ndërkombëtare për vrasjet serike

Tabela nr.1

Shpeshësia e vrasësve serial sipas dekadave në nivel ndërkombëtar


Dekada	Ndërkombëtarisht
1900	23
1910	23
1920	41
1930	31
1940	45
1950	41
1960	76
1970	160
1980	217
1990	322
2000	295
2010	113

Burimi:Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Nëse analizojmë tabelën e mësipërme do të dalim në përgundim që aktivitetet e vrasësve serik më të theksuara janë në vitet e 80-ta dhe 90-ta të shekullit XX. Nga kjo mund të dalim në përfundim logjik se gjatë këtyre dy dekadave numri i vrasësve serik në nivel ndërkombëtarë ka qenë më i lartë, ndërsa në dekadën tashme shënën rënje të dukshme.

Në mënyrë të grafikuar këto të dhëna do të jepnin këtë pasqyrë, ku mund të konkludojmë të njëjtën se në vitet e 80-ta aktivitetet e vrasësve serik përfshijnë 17% ndërsa në vitet e 90-ta një pjesmarrje prej 25%, që konsiderohet më e lartë gjatë kësaj periudhe.

Grafikoni nr.1



Burimi:Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Tabela nr.2

Frekuenca e vrasësve serialë në bazë të gjinisë dhe dekadës

SHBA dhe ndërkombtarisht

Dekada	Numri		Përqindje	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
1900	45	27	62.5	37.5
1910	49	26	65.3	34.7
1920	68	35	66.0	34.0
1930	71	15	82.6	17.4
1940	85	15	85.0	15.0
1950	94	19	83.2	16.8
1960	267	26	91.1	8.9
1970	723	42	94.5	5.5
1980	915	70	92.9	7.1
1990	922	69	93.0	7.0
2000	599	67	89.9	10.1
2010	214	16	93.0	7.0
Gjithsej	4200	541	88.6	11.4

Burimi: Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Nga ajo që mund të vështrohet në tabelën numër 3 është pjesmarrja e madhe e meshkujve si vrasës serik në krahasim me femrat. Nëse bëjmë një analizë detale të të dhënave, mund të vërejmë që në vitet e 70-ta, 80-ta dhe 90-ta egziston një rritje e shpejtë e vrasësve serik të gjinisë mashkullore, mirëpo këtë trend e ndjek edhe gjinia femrore. Gjithsesi, në përqindje femrat janë larg mbrapa meshkujve, ndërsa në të gjitha rastet në dekadat e fundit edhe te njëra palë edhe te tjetra është i dukshëm një ulje e këtij trendi.

3.2. Të dhëna statistikore nga vendet në rajon

Tabela nr.3

Shkalla e vrasjeve në vendet e rajonit

	Norma në 100.000 banorë	Numri i vrasjeve në nivel vjetorë	Viti
Shqipëria	2,70	79	2016
Bosna dhe Hercegovina	1,28	45	2016
Greqia	0,75	84	2016
Kosova	1,60	29	2016
Mali i Zi	4,46	28	2016
Sërbia	1,35	120	2016

Burimi: https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_countries_by_intentional_homicide_rate

Në tabelën nr.10 vihet në pah shkalla e vrasjeve në vendet e rajoni nga e cila tabelë mund të konkludojmë se trendi më i lartë i vrasjeve haset në Sërbi ku më pas i vjen Greqia me 84 vrasje në nivel vjetorë. Mali i Zi sipas të dhënave konsiderot si vendi me numër më të ulët të vrasjeve.

Tabela nr.4

Viktimat e vrasjeve me dashje sipas moshës dhe gjinisë – numri dhe shkalla e përkatësisë gjinore dhe grupeve të moshës

Viti	Kosova	Bosna dhe Hercegovina	Sërbia	Shqipëria	Mali i Zi	Greqia	Bulgaria
2008	113	30	140	93	24	144	172
2009	73	73	154	85	21	152	150
2010	106	56	130	127	15	176	148
2011	62	51	135	142	21	184	128
2012	90	63	111	157	17	166	141
2013	41	46	142	129	10	153	109

2014	41	50	120	117	20	107	116
2015	30	57	104	82	17	93	129
2016	29	45	123	99	28	84	81

Burimi: <http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/>

Nëse bëjmë një analizë të tabelës nr.11 mund të dalim në konkluzionet në vijim: nga viti 2008 deri në vitin 2016 numrin më të lartë të vrasjeve e vërejmë në Sërbi dhe Bulgari ku u pasprin edhe Greqia. Numër më të ulët të vrasjeve kemi në Mal të Zi dhe në Bosnë dhe Hercegovinë. Njëjtë në tabelë mund të vërejmë që numri i vrasjeve në vitet e fundit ka shënuar ramje në krahasim me vitet tjera.

3.3. Të dhëna statistikore në nivel global

Tabela nr.5

Shpeshësia e vrasësve serial sipas dekadave

Dekada	SHBA
1900	49
1910	52
1920	62
1930	55
1940	55
1950	72
1960	217
1970	605
1980	768
1990	669

2000	371
2010	117

Burimi: Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Nëse vështrojmë të dhënat në kolonën e vrasësve serik në SHBA, vërehet se egziston një rritje deri në vitet e 50-ta, ndërsa në 4 dekadat e ardhëshme kjo rritje në mënyrë të dukshme zmadhohet. Në vitet e 80-ta dhe 90-ta të shekullit të kaluar vërehet pjesmarrja dhe aktiviteti më i madh i vrasësve serik, përderisa në dy dekadat e fundit numri i tyre dukshëm zvoglohet.

Tabela nr.6

Vrasësit serial në Shtetet e Bashkuara, bazuar në racë dhe dekadë

Individualisht, në mënyrë ekipore dhe të organizuar					
Dekada	Raca				
	Të bardhë	Zezakë	Latinë	Aziatikë	Amerikan vendas
1900	72.9	25.0	0.0	0.0	2.1
1910	66.7	33.3	0.0	0.0	0.0
1920	78.3	18.3	1.7	0.0	1.7
1930	69.1	30.9	0.0	0.0	0.0
1940	66.7	27.8	1.9	1.9	1.9
1950	69.4	27.8	2.8	0.0	0.0
1960	68.9	28.3	1.4	0.0	1.4
1970	60.9	33.6	4.2	0.3	1.0
1980	53.0	36.8	7.8	0.8	1.7
1990	41.4	47.1	9.0	2.0	0.5
2000	32.3	54.4	11.6	1.1	0.5
2010	30.8	59.8	8.5	0.9	0.0
Gjithsej	51.7	39.8	6.7	0.9	1.0

Burimi:Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Nga fillimi i shekullit të XX është e dukshme se vrasësit serik më aktiv në SHBA janë ato të racës së bardhë, menjëher pas tyre janë ato të racës së zezë, më pastaj vijojnë racat e tjera. Vërehet se në vazhdimsi të dekadave pjesmarrja e vrasësve serik të racës së bardhë zvoglohet, ndërsa përqindja e racës së zezë si vrasës serik rritet. Gjithashtu, është evidente rritje jo edhe aq e rëndësishme edhe tek Latinët, ndërsa tek Aziatikët dhe vendasit këto lëvizje në krahasim me paraprakët është e pa vërejtshme. Në secilin rast vrasësit serik të racës së bardhë janë ende në vendin e parë, por në krahasim të dekadave të mëhershme ky trend është në ulje.

Tabela nr.7

Koficienti i intelegjencës së vrasësve serial

Koficienti i intelegjencës (IQ) i vrasësve serial		
Statistika themelore		
Gjithsej	271	
IQ mesatare	94.5	
Më të ulët	54	
Më të lartë	186	
Metoda e vrasjes	Gjithsej	Mesatare (%)
Bombë	3	140.3
Mbytje/Goditje me mjet të rëndë	8	108.8
Mbytje/Qitje	6	105.8
Helmim	1	100.0
Mbytje	41	96.7
Therrje/Qitje	26	95.0
Therrje	25	92.3
Qitje	61	90.7
Mbytje/Therrje	14	90.2
Goditje me mjet të rëndë/Qitje	11	87.1

Goditje me mjet të rëndë/therrje	11	85.5
Goditje me mjet të rëndë	10	79.1
Viktima përdhunimi		
Jo	143	94.3
Po	127	93.9
Lloj		
I organizuar	128	99.3
Paorganizuar	71	91.3
I përzier	11	102.3
Numri i vrasjeve		
Dy	72	89.1
Tre	60	94.3
Katër	29	92.6
Pesë	21	98.6
Më shumë se pesë	89	98.6
Nekrofilia		
Jo	245	94.1
Po	26	98.2

Burimi: Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Në tabelën nr. 4 vihet në dukje se vrasësit serik që përdorin metoda më të zakonshme të vrasjes, siç janë mbytje, qitje dhe therrje, treguan të jenë me inteligjencë mesatare, ato që përdorin goditjen me një objekt të rëndë dhe kombinimin e tij me të tjera metoda kanë provuar të jenë me inteligjencë të ulët, ndërsa ato që kanë përdorur metoda të jashzakonshme për shembull, bombë zënë vend në të ashtuquajturën gjeniale. Sa i përket pranisë së marrëdhënieve intime apo përdhunimit, atë që dhunonin viktimat e tyre, u treguan më pak inteligjentë sa ata që nuk e bënin një gjë të tillë. Në këtë kontekst, ata autorë që janë të prirur për të praktikuar nekrofilia kanë një nivel inteligjence IQ më të lartë sa ata që nuk e praktikojnë atë. Sa i përket numrit të

vrasjeve, vrasësit serik me 5 ose më shumë vrasje kanë një IQ më të lartë se ata me më pak vrasje, ndërsa të organizuarit zënë vend më të lartë nga ato të paorganizuarit.

Tabela nr.8

Vrasësit serial sipas vendeve

Vendi	Numri i vrasësve serial	% e vrasësve serial	Pjesa e vendit në popullsinë e botës	Raport
SHBA	3.204	67.58	4.35%	15.53
Anglia	166	3.50	0.71%	4.92
Afrika e Jugut	117	2.47	0.74%	3.34
Kanada	106	2.24	0.49%	4.59
Italia	97	2.05	0.80%	2.55
Japonia	96	2.02	1.70%	1.19
Gjermania	85	1.79	1.08%	1.66
Australia	81	1.71	0.33%	5.23
India	80	1.69	17.81%	0.09
Rusia	73	1.54	1.93%	0.80
Franca	71	1.50	0.87%	1.72
Kina	57	1.20	18.56%	0.06
Meksiko	37	0.78	1.73%	0.45
Brazil	27	0.57	2.81%	0.20
Austria	22	0.46	0.12%	4.03
Hungaria	20	0.42	0.13%	3.20
Spanja	17	0.36	0.62%	0.58
Polonia	15	0.32	0.52%	0.61
Skocia	15	0.32	0.07%	4.45
Holandia	12	0.25	0.23%	1.11
Suedia	12	0.25	0.13%	1.91

Vërejtje: Vrasësit serial që veprojnë në shumë shtete nuk janë të përfshira

Burimi: Aamodt, M. G. (2016, September 4). Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database

Siç është konstatuar edhe më herët, SHBA-të janë vendi ku janë të pranishëm dhe aktiv numri më i madh i vrasësve serik. Nga kjo arsye duke marrë parasyshë numrin e tyre, përqindja dhe pjesmarrja e popullsisë në popullsinë botërore këtu raporti është më i lartë. Menjëher pas SHBA-ve, vende me numër më të lartë të vrasësve serik janë Anglia, Afrika e Jugut, Kanada, Italia dhe Japonia etj. duke vërejtur tabelën. Ndërsa si vende me numër më të ulët të vrasësve serik janë Spanja, Polonia, Skocia, Holanda dhe Suedia.

Tabela nr.9

Vrasësit serialë me numrin më të dëshmuar të viktimave

Vrasësit serial	Shteti	Vitet e aktivitetit	Viktimat e dëshmuara
D-r.Harold Shipman	Angli	1975-1998	250
Luis Garavito	Kolumbi	1990-tat	138
Pedro Lopez	Kolumbi, Ekuador, Peru	1969-1980	110
Daniel Kamargo	Kolumbi, Ekuador	1974-1986	72
Pedro Rodriges F.	Brazil	1967-2003	71
Kompatimar Shankarija	Indi	1977-1978	70
Jang Ksinai	Kinë	2000-2003	67
Abdul Xhebar	Avganistan	1970-tat	65
Andrej Çikatilo	Rusi	1978-1990	53
Anatolij Onoprienko	Ukrainë	1989-1996	52
Geri Rixhvej	SHBA	1982-2000	49
Aleksandar Pushkin	Rusi	1992-2006	48

Burimi: <https://www.statisticbrain.com/serial-killer-statistics-and-demographics>

Dr.Harold Shipman është vrasësi serik më i famshëm, me profesion mjek, i cili i ka vrarë pacientët e tij më së tepërmi nëpërmjet injeksioneve vdekjeprurëse me dijamorfin (më i njohur si heroin) që në mjeksi përdoret si opium gjegjësisht si vrasës i dhimbjeve, veçanërisht tek pacientët të sëmurë rëndë. Me një numër prej 250 viktimave, Shipman është në krye të listës.

Në vendin e dytë është i shumëdëgjuari Luis Garavito i cili është sinonim i vrasjeve serike sadiste-seksuale. Pre e tij kanë qenë djem të ri në princip fëmijë, ndërsa ka qenë i njohur për shkak të torturës, dhunimit dhe prerja e kokave të viktimave. Numri prej 138 viktime e vendos të dytin në tabelë, edhe pse ekzistojnë dyshime të kryerjes së qindra vrasjeve të tjera.

Pedro Lopez është i treti me rend, i cili gjithashtu konsiderohet si vrasës serik sadistike-seksuale. Kariera e tij kriminale lidhet me të kaluarën e tij në të cilën si fëmijë ka qenë seksualisht dhe psikofizikisht i keqpërdorur. Me një numër prej 110 viktimave të vërtetuara-vajza të reja, ekzistojnë dyshimi në numrin e përgjithshëm të rreth 300 viktimave.

Tabela nr.10

Vrasësit serial më të njohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vrasësit serial më të njohur në SHBA	Shteti	Vitet e aktivitetit	Viktimat e dëshmuara
Ted Bandi	SHBA	1974-1978	33
Xhon Vejn Gejsi	SHBA	1972-1978	33
Din Korl	SHBA	1970-1973	28
Huan Vajeho Korona	SHBA	1971	25
Vejn Vilijams	SHBA	1979-1981	24
Ronald Dominik	SHBA	1997-2006	23
Erl Nelson	SHBA	1926-1927	22

Burimi: <https://www.statisticbrain.com/serial-killer-statistics-and-demographics>

Ted Bandi i cili konsiderohet ndër vrasësit serik më të famshëm në SHBA në këtë temë master e kemi elaboruar si studim rasti.

Xhon Vejn Gejsi (John Wayne Gacy) është i njohur si "vrasës –palaço" për arsye se ka qenë mjaft aktiv në ngjarje humanitare, parada, shfaqje për fëmijë në të cilat është maskuar si palaço. Pas asaj maske, është fshehur sadist i cili ka vrarë e përdhunuar djem të ri, ndërsa numrin më të madh të viktimave i ka varrosur në shtëpinë e tij. Ka qenë i dënuar me denim me vdekje për të cilën ka pritur 14 vite përpara se të ekzekutohet me injeksion vdekjeprurës.

Den Korl (Dean Corll) si i treti me radhë sipas viktimave të dëshmuara poashtu në këtë punim masteri është elaboluara historia e tij në studimet e rastit –case study.

3.4. Të dhëna statistikore për vrasjet në Republikën e Maqedonisë

Në vazhdim vijonë të dhënat statistikore mbi lëvizjen e kriminalitetit në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2017, më sakt mbi lëndën tonë të interesit edhe atë krime kundër jetës dhe trupit, domethënë vrasjeve. Do të merren parasyshë disa parametra të tillë si gjinia, përkatësia etnike, lloji i sanksioneve, mosha dhe mënyra e ekzekutimit të vrasjeve. Në këtë mënyrë do të japim një pasqyrë më të qartë të gjendjes së këtij lloji të krimet të territorin maqedonas dhe gjithashtu e njehta më tej duhet të sinjalizojë shtetin dhe sistemin e tij gjyqësor në cilin drejtim duhet të lëvizë politika penalo-juridike në këtë sferë.

Tabela nr.11

Të rritur të dënuar sipas grupit të veprave penale

Të rritur të dënuar sipas grupit të veprave penale						
	Viti					
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	9.042	9.539	11.683	10.312	9.320	7.423
Veprat penale kundër jetës dhe trupit						
Vrasje	37	32	34	32	18	32

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Me këtë shqyrtim tabelarë del në pah se numri i të dënuarve madhorë vjen duke u zvogluar. Numri më i lartë shfaqet në vitin 2014, ku arrin 11.683 persona të dënuar . por sa u përket veprave penale kundër jetës dhe trupit numri i tyre sa vjen e shtohet edhe atë kemi një rritje në vitin 2016 dhe 2017. Sa u përket vrasjeve si vepra penale viti më i "frutshëm" konsiderohet viti 2012, ku numri i tyre arrin 37.

Tabela nr.12

Të rriturit e dënuar në periudhën 2014-2015 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)

Të rriturit e dënuar në periudhën 2014-2015 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)									
	Gjithsej		Lloj i sanksionit (kryesor dhe dytësor)						
	Të dënuar	Femra	Gjithsej dënime	Dënimet					
				Kryesore		Dytësore			
				Burgim	Dënim me gjobë	Dënim me gjobë	Ndalim i kryerjes së profesionit	Ndalim i drejtimit të automjetit	Dëbim i të huajit nga vendi
Gjithsej për vitin 2014	11 683	1 126	6 263	3 507	2 532	83	9	97	35
Vepra penale kundër jetës dhe trupit									
Gjithsej	924	63	447	197	247	2	-	1	-
Vrasje	32	-	32	30	-	1	-	1	-
Gjithsej për vitin	10 312	865	5 848	3 524	2 089	88	3	104	40

2015									
Vepra penale kundër jetës dhe trupit									
Gjithsej	790	61	400	215	184	-	-	1	-
Vrasje	32	3	32	32	-	-	-	-	-

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Duke bërë krahasim të numrit të përgjithshëm të dënuarve të vitit 2014 dhe 2015 mund të konkludojmë se i njëjti në vitin 2014 është më i lartë dhe përfshin 11 683 persona. Nëse vështrohet në aspektin gjinorë, gratë paraqiten si kryese në numër më të vogël, në vitin 2014 i kemi në numër si kryese gjithsej 1126 ndërsa si kryese të veprave penale kundër jetës dhe trupit 63 femra, por sa u përket vrasjeve si vepra penale në po të njëjtin vit nuk paraqiten si të evidentuara femra kryese.

Sa i përket vitit 2015 femrat si kryese paraqiten në numër më të vogël edhe atë 865 kryese por është për tu përmendur fakti se si kryese të veprës penale vrasje janë evidentuar 3 femra.

Në aspekt të sanksioneve gjegjësisht sanksione kryesore dhe dytësore gjendja është si në vijim: numri i dënimeve gjithsej në vitin 2014 është më i lartë në krahasim me vitin 2015 dhe përfshin 6263 prej të cilave 447 janë kumtuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit. Sa i përket vitit 2015 nga numri i përgjithshëm 5848 dënime, me gjithsej 400 dënime janë kumtuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit, ndërsa 32 prej të cilave janë shqiptuar për veprën penale vrasje edhe atë të gjitha për dënim kryesorë- me burg.

Tabela nr.13

Të rriturit e dënuar në periudhën 2016-2017 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)

Të rriturit e dënuar në periudhën 2016-2017 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)

	Gjithsej		Lloj i sanksionit (kryesor dhe dytësor)						
	Të dënuar	Femra	Gjithsej dënime	Dënimet					
				Kryesore		Dytësore			
				Burgim	Dënim me gjobë	Dënim me gjobë	Ndalim i kryerjes së profesionit	Ndalim i drejtimit të automjetit	Dëbim i të huajit nga vendi
Gjithsej për vitin 2016	8 172	723	3 834	1 922	1 750	64	1	72	25
Vepra penale kundër jetës dhe trupit									
Gjithsej	761	59	315	133	181	-	-	1	-
Vrasje	28	-	28	28	-	-	-	-	-
Gjithsej për vitin 2017	6 273	550	2 739	1 255	1 393	8	1	65	17
Vepra penale kundër jetës dhe trupit									
Gjithsej	664	42	284	111	173	-	-	-	-
Vrasje	20	1	18	18	-	-	-	-	-

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Sa i përket numrit të përgjithshëm të dënuarve të vitit 2016 dhe 2017 mund të konkludojmë se i njëjti në vitin 2016 është më i lartë dhe përfshin 8172 persona. Nëse vështrohet në aspektin

gjinorë, gratë paraqiten si kryese në numër më të vogël, në vitin 2016 i kemi në numër si kryese të veprave penale gjithsej 723 ndërsa si kryese të veprave penale kundër jetës dhe trupit 59 femra, por sa u përket vrasjeve si vepra penale në po të njejtin vit nuk paraqiten si të evidentuara femra kryese.

Sa i përket vitit 2017 femrat si kryese paraqiten në numër më të vogël edhe atë 550 kryese por është për tu përmendur fakti se si kryese të veprës penale vrasje është evidentuar 1 femër.

Në aspekt të sanksioneve gjegjësisht sanksione kryesore dhe dytësore gjendja është si në vijim: numri i dënimeve gjithsej në vitin 2016 është më i lartë në krahasim me vitin 2017 dhe përfshin 3384 pre të cilave 315 janë shqiptuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit. Sa i përket vitit 2017 nga numri i përgjithshëm 2739 dënime, me gjithsej 284 dënime të shqiptuara për vepra penale kundër jetës dhe trupit, ndërsa 18 prej të cilave janë shqiptuar për veprën penale vrasje edhe atë të gjitha për dënim kryesorë- me burg.

Tabela nr.14

Të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe përkatësisë etnike viti 2012-2017

Të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe përkatësisë etnike viti 2012-2017										
	Gjithsej	Përkatësia etnike								
		Maqedonë	Shqiptarë	Turq	Romë	Vllehë	Serb	Boshnjakë	Të tjerë	Të panjohur
Gjithsej për 2012	9042	4605	1899	457	996	18	80	65	113	809
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	881	535	142	40	68	2	6	7	9	72
Gjithsej për vitin 2013	9539	4361	2152	504	1083	11	49	66	93	1220
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	920	532	126	60	44	4	6	11	9	128

Gjithsej për vitin 2014	11683	6093	2214	549	1180	13	74	105	145	1310
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	924	541	143	34	65	5	10	15	23	88
Gjithsej për vitin 2015	10312	4438	2069	371	1091	17	60	95	270	1901
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	790	435	90	21	41	2	14	11	20	156
Gjithsej për vitin 2016	8 172	3 442	1 744	342	772	21	45	74	117	1 615
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	761	388	122	29	33	1	5	7	15	161
Gjithsej për vitin 2017	6 273	2957	1228	270	587	5	43	40	95	1048
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	664	347	103	30	39	1	5	5	7	127

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Sa i përket tabelës së mësipërme që elaboron stasisikat lidhur me kryesit e veprave penale sa i përket përkatësisë etnike mund të konkludojmë që përkatësia etnike maqedone paraqitet si kryes të veprave penale kundër jetës dhe trupit edhe atë më aktivë kanë qenë në vitin 2014 me përafërsisht 541 persona kryerës nga 6093. Sa u përket viteve tjera mund të themi se numri i

kryesve të përkatësisë etnike maqedone vjen duke u zvogluar por për dallim nga etnikumet tjera qëndrojnë të parët edhe edhe në trend.

Sa u përket shqiptarëve si përkatësi etnike në Maqedoni, vinë të dytit pas përkatësisë maqedone edhe atë më aktiv në vitin 2014 nga gjithsej 2214 vepra penale prej tyre 143 janë vepra penale kundër jetës dhe trupit.

Tek përkatësia etnike turke sipas shprehjes tabelare mund të vërehet se në vitin 2013 kemi numrin më të lartë të veprave penale kundër jetës dhe trupit, dhe ky numër në vitet e ardhëshme vjen duke u zvogluar.

Ndërsa përkatësia etnike rome si kryerës vërehen disa oscilime jo të baraspeshuara ndër vite pa çka si kryes më së shpeshti paraqiten në vitin 2012 me 68 persona.

Tek përkatësitë etnike tjera të paraqitura në tabelë numri i tyre nuk është edhe aq i papërfillshëm.

Tabela nr.15

Persona të vdekur nga vdekje e dhunshme sipas shkaqeve të jashtme të vdekjes, gjinisë dhe moshës (2017)

Persona të vdekur nga vdekje e dhunshme sipas shkaqeve të jashtme të vdekjes, gjinisë dhe moshës (2017)										
Kodet e shkaqeve të vdekjes	Gjinija	Gjithsej	0-4	5-14	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+ panjo hura
Vrasje	Mashkullore	23	-	1	2	5	4	3	5	3
	Femërore	9	-	-	-	1	-	2	3	3
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me varje, stangulim dhe asfiksion	Mashkullore	1	-	-	-	1	-	-	-	-
	Femërore	1	-	-	-	-	-	-	1	-
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore nga mbytja dhe zhytja	Mashkullore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Femërore	1	-	-	-	-	-	-	-	1
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me të shtënë	Mashkullore	3	-	-	1	1	-	-	1	-
	Femërore	-	-	-	-	-	-	-	-	-

arme										
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me armë gjahu dhe armë zjarri më të mëdha	Mashkullore	2	-	-	-	-	2	-	-	-
	Femërore	1	-	-	-	1	-	-	-	-
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me armë zjarri të papërcaktuar	Mashkullore	10	-	1	1	2	1	2	3	-
	Femërore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me një objekt të mprehtë	Mashkullore	4	-	-	-	-	-	-	1	3
	Femërore	1	-	-	-	-	-	1	-	-
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me një objekt të hapur	Mashkullore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Femërore	2	-	-	-	-	-	1	-	1
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me shtyerje nga lartësia	Mashkullore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Femërore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përpjekje për të shkaktuar lëndime trupore me forcë fizike	Mashkullore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Femërore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjetër që nuk janë përfshirë në grupin	Mashkullore	3	-	-	-	1	1	1	-	-
	Femërore	3	-	-	-	-	-	-	1	2

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën nr.12, në vitin 2017 nga vdekja e dhunshme t.e. vrasje kanë vdekur gjithsej 32 persona , nga të cilat 23 të gjinisë mashkullore që në këtë rast përfshijnë numrin më të madh kurse vetëm 9 të gjinisë femërore. Shumica e viktimave meshkuj i takojnë grupmoshës 25-44 vjeç, ndërsa në bazë të këtyre të dhënave numri më i madh i tyre janë vrarë duke shkaktuar lëndime trupore me armë zjarri të papërcaktuar. Sa u përket metodave tjera të vrasjeve janë të pranishme edhe vrasjet me varje, strangulim dhe asfikcion.

Numri më i madh i viktimave të vrara të gjinisë femrore ka pasur në moshën nga 25-34 vjeç.

Mund të konkludohet se meshkujt në krahasim prej femrave janë në numër më të lartë në rolin e viktimave.

Si përfundim i të gjitha statistikave të mësipërme mund të përmbledhim si në vijim:

Në nivel ndërkombëtar, vrasësit më aktivë serik ishin në vitet e 80 dhe 90 të shekullit të kaluar, kryesisht në SHBA (kjo situatë është e pandryshuar edhe aktualisht). Nga aspekti gjinorë meshkujt janë më në numër, edhe pse duhet të theksohet se që nga momenti kur është kushtuar vëmendje grave si pjesë e botës kriminale, janë evidentuar shumë raste të grave si vrasëse serike. Analizuar nga aspekti racor, shumica e vrasësve serial rrjedhin nga raca e bardhë, edhe pse mund të vërehet një rritje e numrit dhe të racës së zezë.

Sa i përket IQ, në përgjithësi, vrasësit serik kanë inteligjencë mesatare (mesatarja e IQ shkon nga 90 në 109). Për më tepër, kur flasim për protofolin e vrasësve serik, më të rrezikshmit dhe më të njohurit klasifikohen si sadistë, veçanërisht me elemente seksuale dhe sadiste dhe si persona me përvoja dhe trauma problematike të fëmijërisë së hershme dhe në rini. Sa u përket tendencave të mëtejshme, vërehet një rënie e këtij lloji të krimit në nivel botëror në dy dekadat e fundit.

Në Republikën e Maqedonisë, në periudhën nga viti 2012 deri 2017, numri më i madh i krimeve u regjistrua në vitin 2014 dhe gjatë gjithë të dhënave statistikore viti 2014 na paraqitet si më "i frytshmi" sa u përket vrasjeve si vepra penale. Gjithashtu edhe viti 2012 haset me numër të lartë të këtyre veprave penale, pasçka në vitet e ardhëshme gjegjësisht të fundit nga viti 2015-2017 kemi një ulje të veprave penale kundër jetës dhe trupit më sakt vrasjet.

Kapitulli 4

Studime rasti –case study në nivel botërorë

Studim rasti- case study në kornizat e Republikës së Maqedonisë

4. Studime rasti –case study në nivel botërorë

Në pjesën e studimeve të rastit në nivel botërorë do të elaborojmë disa nga vrasësit serik më me emër në historinë botërore, prej të cilëve kemi ndarë Dean Korl, Ted Bundy dhe Xhon Movesek. Historitë e tyre janë shumë rrënqethëse, me një numër të madh të viktimave, që nganjëher është edhe e palogjikshme se deri ku mund të shkojë qenia njerzore.

4.1. Rasti.1

Si rast të parë –case study në nivel botërorë do të shqyrtojmë rastin e Dean Korl –njeriu i karamelave që vriste kryesisht adoleshentë.

❖ Shpjegim i rrjedhës së rastit

Dean Korl ishte dikur vrasësi serial më vdekjeprurës në historinë amerikane, por pak e njohin emrin e tij sot. Për të gjithë rrethin e tij, Dean Korl dukej si një njeri i zakonshëm. Ai e shijonte kohën duke e kaluar në fabrikën e vogël të ëmbëlsirave që e posedonte nëna e tij në një lagje të pasur të Hjustonit. Ai shërbeu në Ushtri gjatë Luftës së Vietnamit dhe kurrë nuk pati një dosje penale. Fqinjët e përshkruarin atë si person të qetë, të sjellshëm, të këndshëm, të vëmendshëm dhe gjithmonë të qeshur. Prapa buzëqeshjes, Dean Korl fshehu një sekret vdekjeprurës.⁴³

Midis 13 dhjetorit 1970 dhe 25 korrikut 1973, gjithsej 28 djem, duke filluar në moshën 13-20 vjeç, u zhdukën nga lagja Heights pesë milje në perëndim të qendrës së Hjustonit. Të gjithë u torturuan dhe u vranë nga Dean Korl. Në atë kohë, ai ishte vrasësi serik më prolific në historinë amerikane.

Autoritetet kurrë nuk kanë konstatuar një motiv të qartë, dhe sa më shumë që të gërmonin në tregimin e Dean Korl, aq më e tmerrshme bëhej. Së pari, ai ka rekrutuar dy adoleshentë si bashkëpunëtorë. Njëri ishte 17 vjeçari Wayne Henley dhe tjetri 18-vjeçar David Brooks. Ata i njihnin shumë nga viktimat e Corllit personalisht. Disa nga djemtë e vdekur ishin miqtë e tyre.⁴⁴

⁴³ Biografia e vrasësit serik Dean Korl - https://en.wikipedia.org/wiki/Dean_Corll 13.08.2018

⁴⁴ Mendje kriminale Dean Korl - http://criminalminds.wikia.com/wiki/Dean_Corll. 13.08.2018

Në fund të fundit, pa rrëfimet e këtyre bashkëpunëtorëve, askush nuk do ta kishte ditur ndonjëherë se çfarë ndodhi me djemtë e humbur të Houston Heights. Megjithatë, bashkëpunëtorët zbuluan të gjitha, duke përfshirë metodat shqetësuese të Korllit.

Treshja përdorte makinën e Korllit, Plumouth GTX ose furgonin e tij të bardhë për të joshur viktimat e tyre një nga një në harkun kohorë prej dy vjet e gjysmë. Korl përdorte karamelë, alkool ose premtimin se do të shkonin në një festë për të marrë çdo të ri brenda. Çdokush që hyri në kamion ose makinë nuk do të kthehej kurrë. Korl dhe bashkëpunëtorët e tij do t'i çonin djemtë në apartamentin ose shtëpinë e tij. Atje ata lidhnin dhe ua mbyllnin gojën çdo viktime. Pastaj Korl i detyronte ata të shkruajn kartolinë ose shënime për familjet e tyre për të thënë se ishin në rregull.

Tortura që ai u shkaktonte viktimave të tij i bën vrasjet e tij edhe më të tmerrshme. Korl dhe bashkëpunëtorët e tij do ti zhveshnin ato lakuriq, do ti lidhnin me një copë kompensatë, do të lidhnin duart dhe këmbët dhe pastaj do ti torturonin seksualisht në mënyra të ndryshme para se ti vrisnin. Korl kaloi me këtë për një kohë të gjatë sepse askush nuk dyshonte te ai. Ai zhvendosej shpesh, shpesh çdo dy javë. Vrasjet ndaluan vetëm sepse Henley, një prej bashkëpunëtorëve, më në fund e kishte pasur mjaft. I riu mori armën e Korllit, bërtiti se nuk mund të vriste më shokët e tij dhe e qëlloi Korllin në kokë në shtëpinë e tij me qira në periferi të Pasadena të Houston. Ishte e njejta armë që Korl kishte përdorur për të vrarë viktimat e tij.

Henley dhe bashkëpunëtori i tij, Brooks, u dorëzuan pak kohë më pas.

Policia pastaj mësou se Korl kishte marrë me qera një barkë në një pjesë tjetër të Hjustonit. Hetuesit gjetën 17 viktima të varrosura atje. Gjashtë trupa të tjerë u gjetën në Gadishullin Bolivar, ndërsa katër viktima u gjetën të varrosur në një zonë pyjore në Liqenin Sam Rayburn. Policia nuk identifikoi viktimën e 28 deri në vitin 1983.⁴⁵

Çfarë do të kthejë një njeri të tillë të zakonshëm në një vrasës të tillë të çmendur?

Prindërit e Korllonit u divorcuan kur ishte i ri, pas së cilës qëndroi me nënën e tij. Disa thonë se kjo e bëri atë të zhvillonte zemërimin ndaj figurave mashkullore në jetën e tij. Një tjetër teori është se homoseksualiteti i Korllonit ka luajtur një faktor. Me sa duket ai kishte disa takime seksuale me burra, por Korll i mbante ato private. Ndoshta paaftësia e tij për të pasur një marrëdhënie të ngushtë personale me këdo ishte ajo që e ktheu Korllin më thellë brenda në errësirë dhe donte të bënte një fantazi seksuale me viktimat e tij mashkullore.

⁴⁵ Ibid;

Cilado qoftë motivi i Dean Korllit, ndoshta pjesa më e çuditshme e historisë së tij është se vështirë se dikush e di për një nga vrasësit masivë më shokues në historinë moderne amerikane. Gazetarët e quanin Njeriu i karamelave sepse i joshte fëmijët me karamelë dhe biseda të ëmbla. Megjithatë, historia e tij mori pak vëmendje dhe është pak e njohur sot. Sa i përket bashkëpunëtorëve të Dean Korllit, ata janë ende në burg duke vuajtur burgim të përjetshëm për rolet e tyre në një nga valët më vdekjeprurëse të vrasjeve serike në historinë e Shteteve të Bashkuara.⁴⁶

4.2. Rasti. 2

Ted Bundy, në mënyrë të plotë Theodore Robert Bundy, (i lindur 24 nëntor 1946, Burlington, Vermont, SHBA-vdiq 24 janar 1989, Starke, Florida), vrasës amerikan serial dhe përdhunues, një nga kriminelët më famëkeq të shekullit të 20 .

Bundy kishte një fëmijëri të vështirë; ai kishte një marrëdhënie të tensionuar me njerkun e tij, dhe drojëti i tij e bëri atë një objektiv të shpeshtë të ngacimit. Më vonë, megjithatë, inteligjenca dhe aftësitë e tij sociale i mundësuan atij të gëzonte një karrierë të suksesshme në kolegji dhe ai zhvilloi një seri marrëdhëniesh emocionale të dukshme normale me gratë.⁴⁷

Megjithë këtë stabilitet të dukshëm, ai sulmoi seksualisht dhe vrau disa gra të reja në Uashington, Oregon, Kolorado, Utah dhe Florida, midis viteve 1974 dhe 1978. Megjithëse në fund të fundit do t'i pranonte 28 vrasje, disa vlerësuan se ai ishte përgjegjës për qindra vdekje. Pas një gjyqi të publikuar mirë, ai u dënua me vdekje në vitin 1979 për vrasjen e dy studentëve të kolegjit. Në vitin e ardhshëm ai u dënua me vdekje, këtë herë për përdhunimin dhe vrasjen e një vajze 12-vjeçare. Bundy u ekzekutua në karrigen elektrike të Floridës në vitin 1989.⁴⁸

Gjatë pranverës dhe verës së vitit 1974, policia në veriperëndim të Paqësorit ishte në panik.

⁴⁶ Vrasësit serik më të famshëm Amerikan Dean Korl <https://www.cbsnews.com/pictures/americas-deadliest-serial-killers/18/>. 13.08.2018

⁴⁷ Fëmijëria e Ted Bandit, Shenjat e para se ai ishte një vrasës serik, - <https://www.oxygen.com/crime-time/creepy-moment-ted-bundy-childhood-sign-serial-killer>. 17.08.2018

⁴⁸ Biografia e vrasësit serik Ted Bandi - https://en.wikipedia.org/wiki/Ted_Bundy. 13.08.2018

Gratë në kolegje nëpër Uashington dhe Oregon po zhdukeshin me një normë prej rreth një në muaj, dhe policia kishte pak drejtime se kush ishte prapa saj.

Në gjashtë muaj, gjashtë gra ishin rrëmbyer dhe disa gra të tjera kishin raportuar përpjekje për t'i joshur ata nga një plazh i mbushur me njerëz në Parkun Shtetëror të Liqenit Sammamish, para se dy gra, Janice Ann Ott dhe Denise Marie Naslund, në fakt, u zhdukën po nga ai vend.

Nëna e tij ishte Eleanor Louise Cowell dhe babai i tij ishte i panjohur. Për të shmangur një skandal, ai u rrit nga gjyshja e tij dhe gjyshi i tij abuziv si fëmija i tyre dhe besonte se nëna e tij ishte motra e tij. Gjyshi i tij do ta rrihte rregullisht atë dhe nënën e tij, duke e detyruar atë të ikte me djalin e saj për të jetuar me kushërinjtë në Tacoma, Wash, kur Bundy ishte pesë vjeç.

Atje, Eleanor u takua dhe u martua me kuzhinierin e spitalit Johnnie Bundy, i cili formalisht adoptoi të riun Ted Bundy dhe i dha mbiemrin e tij.

Megjithëse ai e përshkroi veten si një i vetmuar, i cili do të ndiqte rrugët e përgjakura gjatë natës duke kërkuar për të spiunuar gratë, shumë njerëz që kujtojnë Bundy nga shkolla e mesme e përshkruajnë atë si të njohur dhe të pëlqyeshëm në mënyrë të arsyeshme.

Megjithëse ai pranoi shumë prej vrasjeve të tij para vdekjes së tij, numërimi i plotë i viktimave mbetet i panjohur. Ndërkohë, Bundy mohoi disa vrasje, pavarësisht dëshmive fizike që e lidhnin atë me krimet.

Në fund të fundit, e gjithë kjo ka çuar në numërimin e viktimave që variojnë nga 30 deri në 40. Megjithatë shumë njerëz që ai ka vrarë, Ted Bundy mbetet një nga vrasësit seriozë më famëkeq dhe të tmerrshëm në historinë amerikane deri tani.⁴⁹

4.3. Rasti. 3

Xhek Movesek apo i njohur edhe si Jack the Ripper do të shqyrtohet si case study në vijim.

Vrasjet e Jack the Ripper ndodhën në fundin lindor të Londrës në 1888 dhe, edhe pse vrasësi i Whitechapel ishte vetëm një kërcënim për një pjesë shumë të vogël të komunitetit në një pjesë relativisht të vogël të Londrës, krimet kishin një ndikim të madh në shoqëri si një tërësi.⁵⁰

⁴⁹ Vrasësit serik, Muzeu i krimeve, Ted Bandi - <https://www.crimemuseum.org/crime-library/serial-killers/ted-bundy/>. 17.08.2018

Në të vërtetë, duke përqëndruar vëmendjen e shtypit dhe të publikut në përgjithësi në rrugët dhe njerëzit e një nga lagjet më të varfra dhe më të krimit të Londrës, Jack the Ripper, kushdo qoftë ai mund të ketë qenë, arriti të ekspozojë nënvleftën e ligë të shoqërisë viktoriane dhe duke vepruar kështu, ai ndihmoi në krijimin e një ndërgjegjësimi në mesin e qytetarëve më të pasur të Londrës për kushtet e tmerrshme shoqërore, të cilat ishin lejuar të zhvilloheshin, kryesisht të pakontrolluara, në pragun e qytetit të Londrës, milimi më i pasur në tokë.⁵¹

Një nga gjërat që i bën shumë njerëz në lidhje me këtë zbavitje të veçantë të kohë më parë, është mjaft pse krimet ende janë aq të famshme, edhe pse kanë kaluar njëqind e njëzet e pesë vjet që kur ato kanë ndodhur.

Nëse, siç besohet në përgjithësi, Jack the Ripper kishte vetëm pesë viktima, atëherë ai nuk ishte një vrasës veçanërisht pjellor, në krahasim me shumë njerëz që kanë ardhur që nga ajo kohë, dhe fakti se e ashtuquajtura sundimi i terrorit zgjati vetëm njëmbëdhjetë javë do të thotë se ai nuk ishte i lirë për një periudhë veçanërisht të gjatë kohore.

Megjithatë, ka pak dyshime se ai është vrasësi serial më i famshëm në botë.

Pse duhet të jetë kjo?

Disa faktorë janë kombinuar për të ndihmuar që kjo seri e krimeve të bëhet e famshme në mbarë botën. Jo më pak në mesin e tyre ishte fakti se gazetatat e ditës dhanë një numër të madh mbulimesh për krimet dhe u dhanë lexuesve të tyre përditësime të përditshme mbi ta, me ç'rast Jack The Ripper u bë në mënyrë efektive një figurë mediatike kërcënuese.⁵²

Së dyti, zona në të cilën ndodhën vrasjet u perceptua si një vatër e së keqes dhe terrorit, dhe një terren edukate për trazira shoqërore, terror dhe sëmundje. Vrasësi i Whitechapel, në sytë e shoqërisë më të gjerë viktoriane, u bë për t'u parë si personifikimi i të gjitha të këqijave me të cilat u bashkua pjesa Lindore e Londrës.

Së fundi, sigurisht, ishte emri me të cilin u bë i njohur vrasësi - Jack the Ripper.

Emri u shfaq fillimisht si nënshkrimi në një letër që u dërgua në krye të një agjencie lajmesh në Londër në fund të shtatorit 1888.⁵³

⁵⁰ Biografia e Djek Mevosek - <https://www.biography.com/people/jack-the-ripper-9351486> 17.08.2018

⁵¹ Dhjetë fakte të rastit të Djek Mevosek - <https://listverse.com/2014/02/21/10-things-you-probably-dont-know-about-jack-the-ripper>. 18.08.2018

⁵² Udhërrëfues i rastit Djek Mevosek - <http://www.historyextra.com/feature/united-kingdom/your-guide-jack-ripper>. 18.08.2018

⁵³ Web faqja oficiale e rastit të Djek Mevosek - <http://www.jack-the-ripper.org>. 18.08.2018

Ishte ky emër - i cili ishte ndoshta shpikja e një gazetari - që kishte efektin e kthimit të pesë vrasjeve të pahijshme në Lindjen e Fundit në një fenomen ndërkombëtar dhe të katapultimit të gabuar të panjohur i cili ishte përgjegjës për krimet në fushën e legjendës.

Në të vërtetë, vrasjet e Whitechapel janë ndoshta krimet më të studiuara në histori dhe, deri më sot, një sasi e madhe hulumtimi në to ende po zhvillohet në të gjithë botën.

5. Studim rasti- case study në kornizat e Republikës së Maqedonisë

Vrasjet seriale si një fundrrinë dhe skenë e tmerrshme e shoqërisë janë prezente kudo, kështu që në këtë kuptim as edhe Republika e Maqedonisë nuk është kursyer nga ngjarje të tilla të frikshme. Devijimet shoqërore, gjegjësisht devijimet nga rrjedha normale dhe përgjithësisht të pranuarra të jetës, ndonjëher shfaqen nëpërmjet ngjarjeve të tilla të pakëndshme që janë katastrofike për vendin dhe qytetarët e saj. Me qëllim që pjesa teorike rreth vrasjeve serike dhe në përgjithësi sqarimi i tyre i detajuar në lidhje me të ngushta me lexuesit e kesaj teme masteri, do të vijojë analiza e një rasti nga praktika e Republikës së Maqedonisë.

Në këtë mënyrë, ne do të jemi në gjendje të shohim dhe të debatojmë për shfaqjen e vrasjeve serike në botën reale, objektive në të cilën ne të gjithë ekzistojmë dhe mund të analizohen për herë të parë në vendin tonë.

5.1. Rasti. 1

Si rast të parë do të analizojmë të ashtuquajturin "Vrasësi i dilerëve rrugorë të devizave". Në vijim do të paraqesim të dhëna të përgjithshme lidhur me të akuzuarin dhe rastin konkret.

Inicialet: L.R

Gjinia: Mashkullore

Përkatësia etnike: Maqedonase

Biografia: ish fudbollist, gjuetar, alpinist dhe tepriçë teknologjike

Mosha në kohën e sjelljes së vendimit: 62 vjeç
Periudha në të cilën janë kryer vrasjet: 2006-2008
Periudha kohohere e kryerjes së vrasjeve: ora 7-8; ora 12; ora 10-16
Viti i dënimit:2009
Numri i viktimave: 3
Vepra penale: Vrasje nga neni 123 alinea 2 pika 1 e KP
Dënime të mëhershme: Po

❖ Shpjegim i shkurtër i rrjedhës së rastit

Kryerësi L.R konsiderohet si vrasësi i parë serial në Maqedoni, sipas përkufizimit teorik të një vrasësi serial (kryerja e minimum tre vrasjeve ndër të cilat ekziston periudhë "pushimi", në këtë rast në të njëjtën mënyrë në përputhje me pikat e aktakuzës në mënyrë mizore dhe të fshehtë.⁵⁴

Viktima e parë është R.R i vrasur në vitin 2006, viktima e dytë është personi S.S i vrasur në vitin 2007 dhe viktima e tretë është personi T.C i vrasur në vitin 2008. Përveç këtyre , ka dyshime se kryerësi ka kryer dhe një tjetër vrasje në vitin 1999, viktima e të cilit ishte personi T.T. si dhe ka kryer grabitje ndaj personit M.N. Viktimat kanë shkëmbyer monedha të huaja në Bursën e zezë në afërsi të tregut të qytetit në Ohër. Kryerësi i vriste ata në dyqanin ku punonte dhe më vonë i sillte trupat e kufomave në veturën e tij FIAT 1.300 në fshatin Orovnik dhe zona të tjera pyjore ku terreni ishte kodrinor dhe vështirë se ishte i arritshëm, i mbushur me bimësi të harlisur.

Trupat u gjetën rastësisht nga kalimtarë të rastit dhe paraqitën në Ministrinë e Brendshme. Nëpërmjet bashkpunimit në mes Ministrisë së Brendshme-Ohër dhe Prokurorisë Publike – Ohër u anketuan 360 persona dhe u thirrën në bisedë informative 21 persona në 48 orët e para pasi u gjet trupi i viktimës së fundit T.C dhe pjesa më e madhe e tyre u kontrolluan.⁵⁵

Hetimi çoi deri te L.R. kështu që në shtëpinë e tijë u kry kontrollë nga ana e policisë, dhe në bodrumin e shtëpisë ku ai jetonte u gjetën një thikë që kishte gjurmë gjaku, veshje dhe këpucë gjithashtu me gjurmë gjaku, një sasi të parave me njolla gjaku dhe armë që ai zotëronte pa asnjë leje. Pjesë e dëshmitarëve që dëshmuuan kundër L.R. janë K.O dhe A.A të cilët thanë se i

⁵⁴ Lajm në e-gazetën Vecer për vrasësin e dilerëve të devizave- <http://vecer.mk/ohrigjanec-izmasakriral-chetvorica-prodavachi-na-devizi>. 31.08.2018

⁵⁵ Lajm në e-portalin Lajme nga Ohri për aktgjykimin e vrasësit të dilerëve të devizave - <http://www.ohridnews.com/vesti/111752> . 31.08.2018

pandehuri disa herë gjatë vitit 2007 solli makinën e tij në autolarje në të cilën ato punonin. Në një situatë, ata refuzuan të pastronin automjetin sepse u tmerruan nga pamja sepse në ulëse kishte gjurmë gjaku të freskët. L.R. pohonte se gjaku ishte me origjinë shtazore, gjegjësisht se ai ishte gjuetar dhe bëhet fjalë për një kafshë të gjuajtur. K.O më tej theksoi se në bagazhin e veturës kishte një çekan, sopatë dhe mjete të tjera si dhe që xhami i anës së përparme ishte i thyer. Përpara gjykatës si dëshmitarë u paraqit edhe personi V.G kompania e të cilit gjendej afër dyqanit ku i dënuari kishte punuar dhe theksoi se e njohte L.R si dhe viktimën S.S për të cilin aji vuri në dukje se ai ishte një person i ndershëm nga i cili kishte blerë disa herë valutë të huaj. Gjatë procedurës hetimore dhe kohës së kaluar në paraburgim, i dënuari i pranoi të tre krimet, ndërsa më vonë gjatë shqyrtimit kryesorë ai pranoi vetëm vrasjen e fundit të T.C për të cilën ai pohoi se ka ndodhur në vetëmbrojtje, gjegjësisht se ka ndodhur një përleshje për shkak të një borxhi që viktimat ka pasur ndaj kryerësit. Dy vrasjet e tjera, L.R pohoi se i kishte pranuar ato nën detyrim dhe kërcënim. Rasti përfundoi në mënyrë që Gjykata Themelore – Ohër e shpalli fajtor L.R. dhe atë për tre vrasje me burhim të përjetshëm. Aktgjykimi u ankimua nga avokati mbrojtës E.B dhe i dënuari në Gjykatën e Apelit të Manastirit, por e nejtja u refuzua.⁵⁶

❖ Mënyra e kryerjes së vrasjeve

I dënuari vrasjet i ka kryer në mënyrë identike, domethënë në një mënyrë të ulët, fshehtë dhe të paramenduar, duke i njohur paraprakisht viktimat dhe duke i joshur ato të hynë në dyqanin ku ai punonte. Duke vepruar kështu, ai u afrohej atyre nga prapa shpine, duke u dhënë atyre asnjë mundësi për të mbrojtur veten, duke dëshiruar në të njëjtën kohë pasojat e veprës dhe kjo u konsiderua nga gjykata si rrethanë rënduese në lidhje me ninin 123 alinea 2 pika 1 e Kodit Penal.

❖ Mjeti i kryerjes së vrasjeve

Bëhet fjalë për çekan i markës "Euro Tuls" i rëndë disa kilogram. Gjatë kryerjes së obduksioneve nga ana e personave të kualifikuar – ekspert i mjeksisë ligjore në Manastirë, u konstatua se viktimat vdiqën nga një vdekje e dhunshme e shkaktuar nga një objekt i rëndë në zënë e kokës, fraktura, gjakderdhje të brendshme, goditje në nofull, ballë, qepalla dhe veshë.

❖ Vendi i ekzekutimit të vrasjeve

Vrasjet u kryen në një dyqan mallrash sanitare në Ohër.

❖ Profili i viktimave

⁵⁶ Ibid;

Bëhet fjalë për viktime të gjinisë mashkullore mbi 50 vjeç, të martuar, të papunë, dy prej të cilëve kanë punuar së bashku me vrasësin në të njëjtën fabrikë, por pas dështimit të saj kanë mbetur të papunë, kështu që dalje nga kriza ekzistenciale gjetën duke u bërë dilerë të devizave në "tregun e zi" në Ohër. Sipas ekzaminimit mjeko-ligjor, causa mortis përfaqëson contus cerebri ose kontuzion të trurit.

❖ Dëshmitë dhe veprimet hetimore të përdorura në procedurën penale

Si dëshmi dhe veprime hetimore të cilat gjykata i ka marrë në konsideratë për të sjellë aktgjykim, ishin: Analizat e ADN-së, skicat dhe fotodokumentacioni nga vendgjarja, kërkimet në shtëpi, dëshmitë e dëshmitarëve, ekspertiza mjekësore psikiatrike dhe mjekoligjore, vërtetimi për sendet e konfiskuara, deklarata nga i pandehuri etj.

❖ Motivi

Sipas gjykatës, i njëjti duhet të kërkohet në dtrukturën joadekuatë të personit.⁵⁷

5.2. Rasti. 2

Rasti i dytë – case study që do të shqyrtohet në këtë punim master do të jetë vrasësi 28 vjeçar nga Shkupi i cili lexonte Dostoevskin dhe vriste gra.

Inicialet: V.K

Gjinia: Mashkullore

Përkatësia etnike: Maqedonase

Biografia: një djalë i tërhequr, i pari i gjeneratës në shkollë të mesme, shumë intelgjent, i mvarur nga droga.

Mosha në kohën e sjelljes së vendimit: 28 vjeç

Periudha në të cilën janë kryer vrasjet: 2 mars deri 26 tetor 2009

Viti i dënimit: 2010

Numri i viktimave: 4 dhe 2 tentativa për vrasje

Vepra penale: Vrasje nga neni 123 alinea 2 pika 1 e KP dhe neni 123 alinea 2 pika 4 lidhur me nenin 19 të KP.

⁵⁷ Të dhëna për vrasësin serik të dilerëve të devizave - http://anantasesa.blogspot.mk/2008/05/blog-post_3164.html. 31.08.2018

Dënime të mëhershme: Po

❖ Shpjegim i shkurtër i rrjedhës së rastit

Vrasësi V.K sipas aktgjykimit të kumtuar në vitin 2010 në Gjykatën Themelore Shkupi 1 Shkup, u dënua për vrasje të katërfishtë. Nga data 2 mars deri 26 tetor të vitit 2009 V.K vrau personat LL.H, V.B, S.S. dhe E.M , dhe vrasje të dyfishtë në tentativë të personave M.A dhe S.P. Viktimat ishin gra të moshuara dhe pambrojtura të moshës 69-83 vjeç dhe pikërisht sulmet ndaj tyre sipas psikologut S.P rrjedhin nga urrejtja ndaj nënës së tij.⁵⁸

Vrasësi 28 vjeçarë V.K i njohur edhe si "Raskoljnikovi maqedonas" për të cilin ekzistonte opinion publik që ka qenë një djalë i tërhequr, i pari i gjeneratës në shkollën e mesme, ka qenë i hipnotizuar nga protagonistin kryesorë Raskoljnikov i klasikës ruse "Krim dhe ndëshkim" e Fjodor Dostojevski dhe ishte shumë intelektual.

Mirëpo, historia e tij nuk e anashkalon faktin se para se të dënohej me burgim të përjetshëm si vrasës serik, ai ishte dënuar më herët për vepra penale sipas nenit 235 – Vjedhje dhe nenit 236 – Vjedhje e rëndë nga Kodi Penal, dhe përveç kësaj ai ishte edhe një person i varur nga droga. Ka jetuar vetëm me nënën e tij, me shumë gjasa në një marrëdhënie të çrregullt, ndërsa sipas psikologut S.P pikërisht këtu qëndron arsyeja e vrasjeve të tij, më saktësisht vetmia si një faktor kyç.⁵⁹

Mënyra e kryerjes së vrasjeve sipas hetimeve të kryera përbëhet nga ajo që kryerësi V.K me qëllim të drejtpërdrejtë dhe për interes material , ka sulmuar gra të moshuara, të vetmuara dhe të pafuqishme, duke iu afruar me mjeshteri në një mënyrë që ai pretendonte se mbledh të ardhura bamirëse për nënën e tij të sëmurë. Duke përdorur ndjeshmërinë e tyre, ai arrinte të hyjë në shtëpitë e tyre duke i goditur me spuatë të mbështjellur me gazeta në pjesën e kokës pa çka pasoja e vdekjes ka ndodhur në vendngjarje apo pas disa ditëve për shkak të fyrrjeve dhe hematomave të trurit.

Pas çdo vrasjeje, kryerësi merrte nga viktimat sendet prej ari (vathë, hallka, qafore), dhe sipas deklaratave të tij, ai blente drogë. Sipas deklaratave të dëshmitarëve dhe një dëshmitari okularë, hetimi çoi në një bastisje në shtëpinë e tij ku u gjet arma e krimit. Sipas ekspertizës psikopsikiatrike të kryer, kryerësi V.K është person introvert, i frustuar, tepër i ndjeshë, emocionalisht labil, nuk ka elemente psikopatologjike dhe ka një nevojë të pandalshme për substancat

⁵⁸ Lajm ne e-gazetën Vecer për Raskoljnikovin maqedonas - <http://vecer.mk/go-chital-dostoevski-pa-ubival-zheni>. 18.08.2018

⁵⁹ Ibid;

psikoaktive. Sipas psikologut V.V. fakti që autori i veprës penale ishte një narkoman nuk mund të lidhet me vrasjet e kryera, por arsyeja duhet të kërkohet në ndonjë shkelje tjetër të personalitetit të tij. Për më tepër, ai ishte në gjendje të gjykonte, ka pasur një vazhdimësi të vetëdijes, ai e ka kuptuar aktin dhe pasojat e tij, si dhe çrregullime të marrëdhënieve për shkak të përdorimit të opiateve nuk është klasifikuar me ndonjë sëmundje të përherëshme mendore ose sëmundje të përkohshme mendore.⁶⁰

Sipas të mësipërmes, kryerësi u dënua me burgim të përjetshëm nga neni 123 alinea 2 pika 4 e Kodit Penal dhe sipas nenit 123 alinea 2 pika 4 lidhur me nenin 19 të KP në të njëjtën kohë duke përfutur nga dispozita e alinesë 3 të të njëjtit nen të KP sipas të cilës vrasjet e shumëfishta (serike) dënohen me të paktën dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

❖ Mënyra e kryerjes së vrasjeve

Mënyra e kryerjes së vrasjeve sipas hetimeve të kryera përbëhet nga ajo që kryerësi V.K me qëllim të drejtpërdrejtë dhe për interes material, ka sulmuar gra të moshuara, të vetmuara dhe të pafuqishme, duke iu afruar me mjeshteri në një mënyrë që ai pretendonte se mbledh të ardhura bamirëse për nënën e tij të sëmurë. Duke përdorur ndjeshmërinë e tyre, ai arrinte të hyjë në shtëpitë e tyre.

❖ Mjeti i kryerjes së vrasjeve

Mjet i kryerjes së vrasjeve ka qenë një sopatë e mbështjellur me gazeta që për rrethin e gjerë të mos bie në sy se bëhet fjalë për armë të ftohtë.

❖ Vendi i ekzekutimit të vrasjeve

Në shtëpitë e viktimave apo edhe në rrugë ku pasi ka goditur në kokë ka vjedhur arin e tyre që e kanë pasur të varur në qafë, që më vonë ta shiste për të blerë drogë.

❖ Profili i viktimave

Gra në moshe nga 69 deri 83 vjeçe, të moshuara, të vetmuara dhe të pafuqishme.

❖ Motivi

Urrejtja ndaj nënës së tij. Vetmija si faktor kyç.⁶¹

⁶⁰ Lajm në e-portalën Globus për Raskolnikovin maqedonas - <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=BEB02D2614DB4C4A99AE47DE5BC323A8>. 30.08.2018

⁶¹ Lajm në e-portalën Kajgana për aktgjykimin e Raskolnikovit maqedonas - <https://kajgana.com/dozhivoten-zatvor-za-viktor-karamarkov>. 30.08.2018

Konkludime dhe Rekomandime

Vrasjet serike janë fenomen që paraqesin një sfidë për sistemin gjyqësor të vendeve të cilat përballen me të njëjtët, por në të njëjtën kohë kjo është një dukuri që përbën një kërcënim të madh për mirëqenien dhe sigurinë e popullatës. Teritori më i shpeshtë në të cilën ndodhin vrasjet serike janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse kjo nuk përjashton vendet e tjera.

Për pyetjen se çfarë po i ngjall këto ngjarje të tmerrshme dhe të panatyrshme, është realisht rëndë të japësh një përgjigje të vetme dhe të saktë. Ka disa faktorë që luajnë një rol dhe gjejnë rrënjë në fusha të ndryshme, për shembull, gjendjet psikologjike të një personi, problemet financiare, familjet jofunksionale, anomalitë kongjenitale, si dhe motive të ndryshme të tilla si, për shembull, dëshira për hakmarrje, pakënaqësi seksuale, hedonizëm etj.

Bota deri më sot është përballur me vrasës serik të rrezikshëm që morën shumë jetë të pafajshme, duke përfshirë fëmijë, disa prej të cilëve kishin dalë para drejtësisë, por fatkeqësisht disa mbeten një mister i pazgjidhur për shkak të ikjes së të dyshuarve, provave të pamjaftueshme, paaftësia e autoriteteve të persekutimit dhe kështu me radhë.

Në kontekstin e pikëpamjes juridiko-penale, vendet duke u përballur me këtë akt mizor reagojnë në mënyrë uniforme në mënyrë që veprojnë ashpër dhe parashikojnë dënime të rrepta - shpesh me burgim të përjetshëm, ndërsa atje ku është i pranishëm përdoret edhe dënimi me vdekje .

Lidhur me etiologjinë dhe fenomenologjinë tek vrasjet serike theksohet se shumë faktorë luajnë një rol në krijimin e tyre, si objektive dhe subjektive. Gjatë hulumtimit do të përfundohet që si faktorë merren parasysh matrica politike, ekonomike, sociale dhe kulturore e shoqërisë, dhe në të njëjtën kohë predispozicioni biologjik, psikologjik, psikiatrik dhe social-kulturor i individëve që shpjegojnë strukturën e personalitetit të vrasësit serik, i cili ishte shtytësi kryesor për të kryer krime, dhe procesin e përgjithshëm të transformimit të individit në një vrasës serik.

Përsa u përket formave që paraqiten të këtij fenomeni, është vërtetuar se ajo është e përfaqësuar më së shumti në SHBA dhe shpesh janë të pranishme vrasjet serike me një element seksualisht sadist, për më tepër është treguar se edhe pse ky lloj krimi më së shpeshti i atribuohet seksit mashkullor por edhe femrat si kryerse zënë një vend. Gjëja tjetër për t'u vërejtur është se

dallohen disa lloje vrasësish serial që veprojnë në mënyrën e vet, dallohen nga motivet e tyre dhe metodat e tyre. Nëse kalojmë në përhapjen e vrasjeve serike në Republikën e Maqedonisë, sipas rezultateve të hulumtimit del se në vendin tonë prezente janë vrasjet klasike (me format e tyre të kualifikuara dhe të privileguara), përderisa momentalisht ekzistojnë dy dënime të plotfuqishme për kryers të deklaruar si vrasës serial, rastet e së cilëve janë përpunuar në punim. Fillimi i këtij lloji të krimit në territorin tonë është një sinjal shqetësues dhe kjo tregon një lloj "dëmtimi" të bashkësisë shoqërore.

Mund të thuhet se kjo gjeneron disa efekte anësore ose të ashtuquajturat çrregullime patologjike nga rrjedha normale pas së cilës janë disa faktorë dhe pjesëmarrës dhe jo vetëm kryesi si individ. Duke folur për rastin e Xhek Mevosek si shembull i një vrasësi serik të nivelit botërorë, padyshim biem në përfundim se historia e tij është ende një mister i pazgjedhur që intrigon detektivët e tanishëm, studiuesit dhe autorët. Emri i tij është sinonim i mizorisë, pandjeshmërisë, terrorit dhe frikës, dhe për shkak të mungesës së provave të forta dhe të besueshme, ai do të jetë vrasësi më famëkeq serial i shekullit të IXI. Siç është përmendur edhe më parë, për të parandaluar dhe /ose zbutur prirjen e këtyre ngjarjeve kriminale, është e nevojshme që ta parandalojmë atë në mënyrë preventive.

Në vazhdim do të përcjellim disa rekomandime që mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në këtë fushë:

- dekurajimi i idesë së përdorimit të dhunës në media: këtu e dobishme mund të tregohet ideja e përfaqësuesve të "kriminologjisë së paqes" e cila tregon se duhet dalë nga cikli i pafund i agresionit në të cilin përgjigja e vetme e dhunës është kthimi me të njëjtën masë. Në këtë kontekst, sugjerohet që shërbimi publik mediatik që shfaq përmbajtje të tilla në terma goditës nuk mund të mohojnë përgjegjësinë për valën e dhunshme që përfshiu botën;

- kontroll më i madh mbi substancat psikoaktive : është vërtetuar se një numër i madh vrasjeve serike ndodhin nën ndikimin e alkoolit dhe narkotikëve. Sa i përket alkoolit, i njejtë kufizohet bazuar në disponueshmërinë e tij në vende të caktuara dhe në kohë të caktuar, si edhe moshës së caktuar të konsumuesve edhe pse nuk është sekret se në shumë objekte hotelerike bëjnë përjashtim në këtë drejtim kuptohet për arsye përfitimi. Sa i përket përhapjes së narkotikëve këtu luan një rol të madh trafikimi i paligjshëm i drogës, dhe kjo sërish lihet në kurriz të shtetit, i cili duhet të forcojë mekanizmat e tij për shuarjen e këtij fenomeni;

-mbrojtje më e madhe e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit: u gjet që në biografinë e vrasësve serik shpesh është prezent roli i tyre si viktimë të dhunës (fizike, psikike, seksuale) në fëmijëri, edhe ajo është pikërisht gjeneza e transformimit të tyre në monstrume. Prandaj, është e nevojshme një përpjekje më e madhe nga ana e institucioneve formale dhe joformale për të çrrënjësuar këtë problem, sepse fëmijë dhe të rinjë të shëndetshëm, të lumtur dhe të strehuar janë kusht për një shoqëri të shëndoshë dhe një jetë cilësore;

-vëmendje të veçantë ndaj personave që janë të predispozuar ndaj sjelljeve të dhunshme dhe kriminale: institucionet formale dhe joformale përsëri luajnë një rol kyç në këtë pjesë, kështu që individët që tregojnë prirje të tilla duhet të kenë një regjim të veçantë dhe profesional dhe trajtim me të cilin në të njëjtën kohë të drejtat e tyre do të respektohen dinjitetshëm, por edhe rreziku si autorë të mundshëm do të eliminohet.

Në fund, rezultatet deri te të cilat arritëm nëpërmjet këtij punimi master dhe hulumtimit të përgjithshëm, padyshim e konfirmojnë hipotezën e përgjithshme dhe hipotezat tjera ndihmëse. Më konkretisht, u vërtetua se vrasjet serike janë veprime kriminale të kryera në një mënyrë të veçantë me dhunë të shprehur, në periudha të caktuara kohore, motivet e të cilit shpesh shtrihen thellë në psikologjinë e kryerësit, siç edhe ishte vendosur në hipotezat e përgjithshme apo ndihmëse.

Republika e Maqedonisë, si një shoqëri pas tranzicionit, fatkeqësisht me një mjedis politiko-ekonomik jo të qëndrueshëm, vlera normative që janë në përplasje për shkak të ndikimeve të ndryshme të vendeve të zhvilluara, paraqet një strehë e kriminalitetit në përgjithësi dhe një bazë e mirë për intensifikimin e çështjes së vrasjeve serike.

Bibliografia

I-LIBRA

1. Biagi – Chai Francesca, Serial Killers Psychiatry, Criminology, Responsibility (Routledge 1 edition), 2012.
2. Waller S. Serial Killers Philosophy for everyone, Being and killing, Blackwell edition, 2010.
3. Kambovski & Ismail Zejneli Vlado, E drejta penale, pjesa e pergjithshme, Tetove, 2018
4. Zejneli Ismail, E drejta penale : pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
5. Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë: Universiteti Fama, 2007
6. Sulejmanov Zoran, Ubistvata vo Makedonija, Skopje, 1995
7. Pradel Jean , E drejta penale Evropiane, Tiranë : Papyrus, 2010
8. Muçi Shefqet, E drejta penale : pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007
9. Koteski Marjan, Kriminalisticki karakteristiki kaj ubistvata, 2nd edition, 2006
10. Jonathan Herring, E drejta penale: teori, kazuse dhe materiale: volumi 1, 5th edition, Tiranë : UET Press, 2013
11. Petroviq Borisllav, E drejta penale, Sarajevë/ Prishtinë, 2007
12. Salihu Ismet, E drejta penale: Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003
13. Elezi Ismet, E drejta penale: pjesa e posaçme, Tiranë, 2007
14. Kancev Metodija, Pregledna naucna statija UDK:343.611:340.13(497.7) –Kvalificirani (teski) ubistva
15. N. Kocsis Richard, Serial Murder and the Psychology of Violent Crimes, Humana Press New York, USA, 2008.
16. Aamodt, M. G. (2016, September 4) Serial killer statistics - Radford University/FGCU Serial Killer Database.
17. Egger, S. A. (1990). Serial murder: An elusive phenomenon. New York: Praeger.
18. Egger, S. A. (1998). The killers among us: An examination of serial murder and its investigation. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.
19. Fox, J. A., & Levin, J. (1994). Overkill: Mass murder and serial killing exposed. New York:

Plenum.

20. Hickey, E. W. (1997). *Serial murderers and their victims* (2nd ed.). Pacific Grove, CA: Brooks/Cole.
21. Holmes, R. M., & DeBurger, J. (1988). *Serial murder*. Newbury Park, CA: Sage.
22. Keeney, B. T. (1995). Serial murder: A more accurate definition. *International Journal of Offender Therapy and Comparative Criminology*, 39, 298-306.
23. C. Kluckhohn, H. Murray, & D. Schneider (Eds.), *Personality in nature, society, and culture* (pp. 53-67). New York: Knopf.
24. Leyton, E. (Ed.). (2000). *Serial murder: Modern scientific perspectives*. London: Ashgate.
25. Lent, C. (1985, August). Crime scene and profile characteristics of organized and disorganized murderers. *FBI Law Enforcement Bulletin*, 54, 18-25.
26. Skrapec, C. A. (1996). The sexual component of serial murder. In T. O'Reilly-Fleming (Ed.),
27. *Serial and mass murder: Theory, research and policy* (pp. 155-179). Toronto: Canadian Scholars' Press.
28. Skrapec, C. A. (1997). *Serial murder: Motive and meaning*. Dissertation Abstracts International, 58(9), 3731A-3732A. (University Microfilms No. 9808004)

II- Burime tjera

29. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 123 al.3 nga 06.08.1996, me ndrzshimet e fundit dhe plotësimet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nr. 196 të 10.11.2015.
30. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë : teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010
31. Kodi Penal i Suedisë online available
<https://www.government.se/contentassets/5315d27076c942019828d6c36521696e/swedish-penal-code.pdf>.
32. Kodi Penal i Republikës së Kosovës online available
<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>, 08.10.2018
33. Newton Michael, *The Encyclopedia of serial killers*, second edition, New York, 2006.
34. Krivicni zakonik, Sl.Glasnik RS br. 85-2005-111

35. Aamodt, M. G. (2016, September 4) *Serial killer statistics* - Radford University/FGCU Serial Killer Database.
36. Petrovic Nikola, *Pravnoantropoloska analiza krivicnog dela ubistva u proslosti i danas*, Institut za pravo i finansije, Beograd, 2015 online available <http://ipf.rs/pravnoantropoloska-analiza-krivicnog-dela-ubistva-u-proslosti-i-danas>. 25.08.2018
37. E drejta penale Pjesa e posaçme me shembuj praktik- Ligjërata të autorizuara online available <https://www.scribd.com/document/321972419>. 15.07.2018
38. Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, *Të rritur të dënuar sipas grupit të veprave penale (2012-2017)*, Shkup
39. Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, *Të rriturit e dënuar në periudhën 2014-2015 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)*, Shkup
40. Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, *Të rriturit e dënuar në periudhën 2016-2017 sipas llojit të krimit (vrasjes) dhe sanksionit të theksuar (kryesor dhe dytësor)*, Shkup
41. Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë , *Të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe përkatësisë etnike viti 2012-2017* , Shkup
42. Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë , *Persona të vdekur nga vdekje e dhunshme sipas shkaqeve të jashtme të vdekjes, gjinisë dhe moshës (2017)*, Shkup
43. Të dhëna statistikore ndërkombëtare- <https://www.statisticbrain.com/serial-killer-statistics-and-demographics>. 29.07.2018
44. Të dhëna statistikore të vendeve në rajon <http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/> 12.08.2018
45. Biografia e vrasësit serik Dean Korl - https://en.wikipedia.org/wiki/Dean_Corll 13.08.2018
46. Mendje kriminale Dean Korl - http://criminalminds.wikia.com/wiki/Dean_Corll. 13.08.2018
47. Vrasësit serik më të famshëm Amerikan Dean Korl <https://www.cbsnews.com/pictures/americas-deadliest-serial-killers/18/>. 13.08.2018
48. Biografia e vrasësit serik Ted Bundy - https://en.wikipedia.org/wiki/Ted_Bundy. 13.08.2018
49. Vrasësit serik, Muzeu i krimeve, Ted Bundy - <https://www.crimemuseum.org/crime-library/serial-killers/ted-bundy/>. 17.08.2018

50. Fëmijëria e Ted Bundy, Shenjat e para se ai ishte një vrasës serik, - <https://www.oxygen.com/crime-time/creepy-moment-ted-bundy-childhood-sign-serial-killer>. 17.08.2018
51. Biografia e Djek Mevosek- <https://www.biography.com/people/jack-the-ripper-9351486> 17.08.2018
52. Udhërrëfues i rastit Djek Mevosek - <http://www.historyextra.com/feature/united-kingdom/your-guide-jack-ripper>. 18.08.2018
53. Dhjetë fakte të rastit të Djek Mevosek - <https://listverse.com/2014/02/21/10-things-you-probably-dont-know-about-jack-the-ripper>. 18.08.2018
54. Letrat e Djek Mevosek - http://www.casebook.org/ripper_letters. 18.08.2018
55. Web faqja oficiale e rastit të Djek Mevosek - <http://www.jack-the-ripper.org>. 18.08.2018
56. Lajm në e-gazetën Vecer për Raskolnikovin maqedonas - <http://vecer.mk/go-chital-dostoevski-pa-ubival-zheni>. 18.08.2018
57. Lajm në e-portalin Globus për Raskolnikovin maqedonas - <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=BEB02D2614DB4C4A99AE47DE5BC323A8>. 30.08.2018
58. Lajm në e-portalin Kajgana për aktgjykimin e Raskolnikovit maqedonas - <https://kajgana.com/dozhivoten-zatvor-za-viktor-karamarkov>. 30.08.2018
59. Aktgjykim të Gjykatës themelore Shkupi I Shkup, XIII K 447/10 për rastin e Raskolnikovit maqedonas
60. Lajm në e-gazetën Vecer për vrasësin e dilerëve të devizave- <http://vecer.mk/ohrigjanec-izmasakriral-chetvorica-prodavachi-na-devizi>. 31.08.2018
61. Lajm në e-portalin Lajme nga Ohri për aktgjykimin e vrasësit të dilerëve të devizave - <http://www.ohridnews.com/vesti/111752> . 31.08.2018
62. Lajm në e-portalin TVM Televizioni Ohër për vrasësin e dilerëve të devizave - <http://tvm.mk/vesti/ohrid/2287-prodolzi-sudski-proces-laze-radeski>. 31.08.2018
63. Të dhëna për vrasësin serik të dilerëve të devizave - http://anantasesa.blogspot.mk/2008/05/blog-post_3164.html. 31.08.2018

Shtojcë

Fakte lidhur me vrasësit serik

- Sipas FBI-së, më shumë se 70% e vrasësve serik kanë përjetuar probleme në lidhje me abuzimin e substancave. Ndërsa vetëm disa vrasës serik ishin të varur nga alkooli dhe substancat, shumë prej tyre i përdorën ato në rininë e tyre.
- Shumë vrasës serik kanë përjetuar ngjarje seksualisht të vështira në fëmijëri.
- Pothuajse të gjithë vrasësit serik pranojnë se ata filluan duke vepruar nga fantazitë e tyre në kafshë të vogla para se të kryenin vepra në njerëz dhe se tortura e kafshëve u solli atyre një burim të madh kënaqësie. Duke qenë se shumica e vrasësve serik rrjedhin nga familjet jofunksionale, sjellja e tillë patologjike dhe anormale mund të injorohet. Për shembull, babai i Xhefroi Dahmer nuk kishte asnjë shqetësim se djali i tij kryente disekse të kafshëve.
- Steven Egger, në librin e tij "Vrasja midis nesh", vëren se vrasësit serik shpesh zbulohen se kanë një marrëdhënie të pazakontë ose të panatyrshme me nënat e tyre.
- Një studim historik i vrasësve serik do të duhej të fillonte të paktën sa më here se perandori romak Caliguala, i cili gjente kënaqësi të madhe në tortura dhe vrasje.
- Shumica e vrasësve serik janë të rinj: 44% filluan kur ishin në të 20 –tat e tyre, 26% në adoleshencë dhe 24% në të 30-ta.
- Në pothuajse 15% të rasteve të vrasësve serik , viktimat zgjidhen tërësisht në mënyrë të rastësishme.
- Vrasja serike më profilike femër në histori është Eliza beth Bathori (1560-1614). Pas vdekjes së burrit të saj, ajo dhe katër bashkëpuntorë u akuzuan për torturimin dhe vrasjen e qindra vajzave dhe grave të reja. Një dëshmitarë e vendosi numrin në 600 viktimat, megjithëse ata u dënuan për vetëm 80 viktimat.
- Historianët vërejnë se legjendat si ajo e ujqërve dhe vampirët u frymëzuan nga vrasësit serialë mesjetarë.